

# UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE



## PUNIM DIPLOME MASTER

**Tema: “Veprat penale te vjedhjes ne territorin e Gjykates Themelore Gjilandege Viti gjate periudhes 2015-2018”**

**Profesor : Ismajl Zejneli**

**Kandidatja: Sara Ahmeti**

**TETOVË 2019**

# **Përmbajtja**

|  |           |
|--|-----------|
| <b>Abstrakt:</b> .....   | <b>4</b>  |
| <b>HYRJA</b> .....   | <b>5</b>  |
| <b>KAPITULLI I</b> .....   | <b>6</b>  |
| <b>1.0 Historiku i veprave penale te vjedhjes</b> .....  | <b>6</b>  |
| 1.1 Nocioni I vepres penale te vjedhje.....  | 8         |
| 1.2 Karakteristikë e veprave penale te vjedhjes .....  | 11        |
| <b>2.0 Aspektet krahasuese ne legjislacionet e vendeve te tjera</b> .....                                  | <b>12</b> |
| 2.1 Veprat penale te vjedhjes ne R.Kosoves .....   | 12        |
| 2.2 Veprat penale te vjedhjes ne R.Shqiperise .....  | 13        |
| 2.3 Veprat penale te vjedhjes ne R.Maqedonise .....  | 14        |
| <b>Kapitulli i II</b> .....  | <b>16</b> |
| <b>1.0 Veshtrim historic per veprat penale e vjedhjes ne legjislacionine e Republikes se Kosoves</b> ..... | <b>16</b> |
| 1.1 Kuptimi dhe karakterstikat e vjedhjes .....  | 18        |
| 1.2 Objekt i vjedhjes.....   | 21        |
| 1.3 Figura ligjore e vepres penale te vjedhjes.....  | 23        |
| 1.4 Teorite ne lidhje me kryrjen e vepres penale te vjedhjes.....  | 24        |
| 1.5 Menyrat dhe koha e veprave penale te vjedhjes.....   | 24        |
| Psh. Kemi te bejme me vjedhjen te sherbimeve dhe mashtrim.....   | 26        |
| 1.6 Motivet e tyre ne kryrjen te veprave vjedhjes.....   | 27        |
| <b>2.0 Disa nga llojet e veprat penale te vjedhjes sipas Kodit Penal te Kosoves –Pjesa e posaqme</b> ..... | <b>28</b> |
| 2.1 Kuptimi i vjedhjeve te rende .....   | 28        |
| 2.2 Kuptimi i vjedhjeve te shërbimeve .....  | 31        |
| 2.3 Vjedhja grabitqare.....  | 32        |
| 2.4 Mashtirimi .....   | 34        |
| 2.5 Fajdet .....   | 36        |
| 2.6 Uzurprimi i paligjshem i prones se paluajtshme te huaj .....   | 38        |
| <b>3.0 Llojet e shqiptimit te sanksioneve penale për veprat penale te vjedhjes</b> .....                   | <b>40</b> |
| 3.1.Kuptimi i dënimit dhe karakterstikat e saj per veprat penale te vjedhjes .....                         | 40        |
| 3.2.Dënime me burgim për veprat penale te vjedhjes .....   | 42        |
| 3.3. Dënimi me gjobë për veprat penale te vjedhjes.....  | 44        |
| 3.4. Zëvendësimi i dënimeve me dënime tjera për veprat penale te vjedhjes.....                             | 46        |
| 3.5. Qellimi i dënimit ndaj te denuareve per veprat penale te vjedhjes .....                               | 51        |
| 3.6 Kohëzgjatja e denimeve për veprat penale te vjedhje .....  | 52        |

|  |           |
|--|-----------|
| <b>Kapitulli i III- te .....</b>   | <b>55</b> |
| <b>1.0 Vellimi dhe dinamika e veprave penale ne territorin e Gjykates Themelore Gjilan-dega Viti per periudhen 2015 dhe 2018.....</b>              | <b>55</b> |
| 1.1 Dënimet e shqiptuara të vjedhjes nga gjykata themelore Gjilan- dega Viti për vitin 2015-2016 .....   | 57        |
| 1.3 Dënimet e shqiptuara te vjedhjes nga Gjykata Themelore Gjilan- dega ne Viti për vitin 2016-2017 .....  | 59        |
| 1.4 Dënimet e shqiptuara te vjedhjes nga Gjykata Themelore Gjilan- dega ne Viti për vitin 2018 .....   | 60        |
| <b>2. Karakteristika personale te dënuareve me dënime për veprat penale te vjedhjes në territorin e Gjykates Themelore Gjilan -dega Viti .....</b> | <b>61</b> |
| 2.0. Moshë e të dënuareve .....  | 61        |
| 2.1 Gjinia e dënuareve .....   | 62        |
| 2.2 Përkatesia kombëtare .....   | 64        |
| 2.3 Statusi social.....  | 65        |
| 2.5 Statusi martesor .....   | 65        |
| 2.4 Niveli arimorë i dënuareve .....   | 66        |
| <b>Kapitulli i IV-te .....</b>   | <b>68</b> |
| <b>Parandalimi dhe luftimi i veprave penale të vjedhjes kur shqiptohen sanksionet penale ...</b>   | <b>68</b> |
| <b>1.Masat preventive .....</b>  | <b>68</b> |
| 1.0. Arsimimi dhe edukimi .....  | 68        |
| 1.1 Roli i mediave të shkruara dhe elektronike .....   | 69        |
| 1.2. Organizata joqeveritare .....   | 71        |
| 1.4 Roli I familjes .....  | 73        |
| <b>2.Masat represive .....</b>   | <b>76</b> |
| 2.1. Policia .....   | 76        |
| 2.2. Prokuroria .....  | 79        |
| 2.3. Gjykatat.....   | 82        |
| 2.4. Institucionet penitenciare.....   | 85        |
| <b>Konkluzion.....</b>   | <b>86</b> |
| <b>Biblografia .....</b>   | <b>86</b> |

**Abstrakt:**

Mbrojtja juridike penale e pronës private, daton që nga koha e lindjes së shtetit dhe së drejtës. Në kuptimin e gjerë, në veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë të gjitha ato vepra, të cilat janë të drejtuara kundër pronës, gjegjësisht që kryerësi vetes t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, pa marrë parasysh se a gjenden në këtë grup, apo në ndonjë grup tjetër të veprave penale.

Në raport me veprat penale, të cilat janë kryer në të kaluarën, veprat e sotme penale, kryesisht dallohen sipas mënyrës, formës dhe teknikës së kryerjes.

Edhe sot ekzistojnë vepra penale kundër pasurisë si: vjedhje, vjedhje të rënda, vjedhje grabitqare, mashtrime dhe vepra penale të tjera klasike, por mënyra e kryerjes së veprave penale të cekura ka ndryshuar, duke iu përshtatur raporteve të reja pasurore, si dhe mundësive bashkëkohore, teknike dhe mjeteve të cilat shfrytëzohen gjatë operacioneve dhe transaksioneve të ndryshme financiare.

Sot vjedhjet, mashtrimet dhe veprat të tjera kryhen shpeshherë përmes futjes, fshirjes apo ndryshimit të të dhënave kompjuterike, apo programeve dhe mënyrave tjera të ndikimit në rezultatet e procedimit të përpunimit elektronik të të dhënave përmes të të cilave kryhen dobi pasurore të kundër ligjshme jashtëzakonisht të mëdha.

## **HYRJA**

Rendësia e kesaj teze të punimit master , qendron se faktin se do te studioj një ceshtjë konkrete dhe te nevojshme për opinionin publik, qe kemi te bejëm me vjedhjet në RKS ne nivel komunal . Si qëllimi kryesor i këtij studimi në mënyrë te hulumtimit shkencore është qe të nxjerrë realitetin në vendin e Kosovës, dhe luftimin e tyre edhe statistikat pergjatë periudhave kohore të gjykates themelore gjilan –dega ne viti gjate viteve 2015-2018.

Ky punim është i rëndesishem shkaku se jemi në shpalosjen e saj, mëqenese se ajo nuk është shuar asnjherë ose ndaluar dhe nuk do ndalet asniherë e as në te ardhmen e largjet , por teza e kesaj teme do të gjej përgjigje për shumë raste, ngjarje rreth saj.

Synimi i ketij titulli te temes përgjithësisht është te kontribojë në drejten penale – pjesa e posaçme dhe tek zbatimi i ligjeve cilat parashihen për të, edhe pse ka mjaftushemëri njohuri në mënyrë teorike dhe praktike për këtë fushë , por prap bindjet e mia qendrojnë ne atë qe nevojitet ende njohuri në kerkimin shkencor te kesaj fushe..

Pergjithësisht mendojë qe ja vlen te punohet ky studim edhe përkundrazi qe qytetaret jane te informuar mjaftushem për raste tilla , e verteta është nga fakti se personat fare nuk e kanë iden se ku qendron problemi i gjitha ketyre veprave penale te vjedhjes nga qendrimi mbrapa ! Si nga ndikimet e faktoreve të jashtme dhe të mbrendshme!

Me gjithë bindjen time besojë dhe shpresojë qe sadopak do të kontribojë qe ky hulumtimë do te na sherbejë për ta konkretizuar të drejten penale tek pjesa e posaçme qe është pjesë vet kjo veper.

## **KAPITULLI I**

### **Kuptimi dhe karakteristikat dhe aspektet krahasues te veprave penale te vjedhjes**

#### **1.0 Historiku i veprave penale te vjedhjes**

Vjedhja është delikt më i vjetër i së drejtës civile i njohur qysh nga e drejta romake me termin *furtum*. Vjedhja, apo *furtum* në të drejtën romake ishte delikt, që do të thoshte cënim i pasurisë së huaj, krahas nxjerrjes së njëkohshme të dobisë për delikuentin.<sup>1</sup>

Ky ishte kuptimi fillestar i vjedhjes (*furtum*), përmbajtja e të cilit më vonë do të zgjerohet me qëllim të ruajtjes sa më të sigurtë të poseduesve të pronës nga shtresat e varfëra.

Vjedhja është përvetësimi i qëllimshëm kundërligjor i pronës së luajtshme, e kryer me qëllim të përfitimit.

Veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë në të ashtuquajturin kriminalitet klasik dhe janë të njohura edhe me ligjet penale më të vjetra.<sup>2</sup>

Me pasuri, nënkuptohen sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, të drejtat pronësore dhe interesat pronësore,<sup>3</sup> të cilat i takojnë personit fizik dhe juridik . Mbrojtja juridike penale e pronës private, daton që nga koha e lindjes së shtetit dhe së drejtës.

Në kuptimin e gjerë, në veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë të gjitha ato vepra, të cilat janë të drejtuara kundër pronës, gjegjësisht që kryerësi vetes t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, pa marrë parasysh se a gjenden në këtë grup, apo në ndonjë grup tjetër të veprave penale.

Në raport me veprat penale, të cilat janë kryer në të kaluarën, veprat e sotme penale, kryesisht dallohen sipas mënyrës, formës dhe teknikës së kryerjes.

---

<sup>1</sup> Salihu, Ismet, E drejta penale, pjesa e veçantë, Prishtinë, 2009, fq. 339.

<sup>2</sup> ligjin e pronësisë; Në ligjin e pronës: Penale

<sup>3</sup> Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011

Edhe sot ekzistojnë vepra penale kundër pasurisë si: vjedhje, vjedhje të rënda, vjedhje grabitqare, mashtrime dhe vepra penale të tjera klasike, por mënyra e kryerjes së veprave penale të cekura ka ndryshuar, duke iu përshtatur raporteve të reja pasurore, si dhe mundësive bashkëkohore, teknike dhe mjeteve të cilat shfrytëzohen gjatë operacioneve dhe transaksioneve të ndryshme financiare.

Sot vjedhjet, mashtrimet dhe veprat të tjera kryhen shpeshherë përmes futjes, fshirjes apo ndryshimit të të dhënave kompjuterike, apo programeve dhe mënyrave tjera të ndikimit në rezultatet e procedimit të përpunimit elektronik të të dhënave përmes të të cilave kryhen dobi pasurore të kundër ligjshme jashtëzakonisht të mëdha.

Mbrojtja e pasurisë, e cila përfshinë jo vetëm sendet-objektet, por edhe mbrojtjen e të drejtave pasurore (nga mashtrimi, shtrëngimi) dhe interesave pasurore (cenimi i interesave pasurore - është keqpërdorimi i besimit) në masën më të madhe realizohet me masat e së drejtës civile dhe ekonomike, ndërsa me aplikimin e sanksioneve penale, vetëm kur vjen deri te cenimi, apo rrezikimi i pasurisë, ka ardhur përmes përdorimit të forcës, k<sup>4</sup>ercënimit, shantazhit apo përmes veprimeve të ngjashme, që janë me rrezikshmëri shoqërore.

Mund të theksohet, se kjo mbrojtje është e kufizuar për arsye se, kryesisht ka të bëjë me cenimin e drejtave pasurore, që janë gjëra të luajtshme, ndërsa në raste të rralla te ato të paluajtshme dhe për arsye se me këtë mbrojtje janë përfshirë cenimet të bëra me paramendim.

Megjithatë, pa marrë parasysh nivelin e kufizuar të mbrojtjes juridike penale pasurisë, rëndësia e kësaj mbrojtje është e pakontestueshme. Në kuadër të mbrojtjes juridike të pasurisë, mbrojtja juridike penale pa dyshim paraqet vetëm një pjesë të saj, por specifike dhe shumë të rëndësishme, se pa mbrojtjen juridike penale nuk mund të mendohet mbrojtja efikase dhe efektive e pasurisë. Për këtë dëshmojnë, veçanërisht numri jashtëzakonisht i madh i veprave penale të vjedhjes në bote.<sup>5</sup>

---

<sup>4</sup> 4 Salihu, Ismet, E drejta penale, pjesa e veçantë, Prishtinë, 2009, fq. 339

<sup>5</sup> Fletcher, George P. (1998). Konceptet themelore të së drejtës penale . Oxford University Press. ISBN 0-19-512170-8 .

## 1.1 Nocioni I vepres penale te vjedhje

Veprat me të cilat cenohet, dëmtohet apo asgjësohet vlerat juridike të njeriut dhe së caktuar, në të drejtën penale quhen vepra penale. Pra vepra penale e vjedhjes po, ze vend qendror ne boten bashkehore ne legjislacionet penale.<sup>6</sup>

Me veper penale te vjedhjes nenkuptojme kur ajo kryhet kur dikush merr “pasuri të patundshme të një personi tjetër me qëllimin që në mënyrë të paligjshme ta përvetësojë atë për veten e tij”, vepra penale e e vjedhjes kryhet kur një person përvetëson fitim pasuror ngai një person ne menyre te kunderligjshme,e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm .Te vjedhësh është të marrësh diçka që nuk është e jotja.

Kemi shume perkufizime dhe terme te ndryshme rreth nocionit te kesaj vepre penale sic e lartepremdem me larte, te cilat do i permendemi disa nga to meposhte.

Vjedhja konsiderohet kur kryhet ne rastet kur ndokush e merr pasurine e huaj te tundshme me qellim qe vetit apo tjetrit ti sjell.

Me termin vjedhje nenkuptojmë marrjen i një të mire materiale (e luajtshme) , me qëllim të përvetsimit, ne mënyrë të kunderligjshme per vete ose per personin tjetet. Vjedhja në ligj, eshte një term i përgjithshëm që mbulon një shumëllojshmëri të llojeve të veçanta të vjedhjes, duke përfshirë krimet e vjedhjes si grabitja, mashtrimi, placktija etj.

Kjo vepër penale është e përhapur në gjithë botën ,në forma të ndryshme ne dobi pasurore te kunderligjshme. Objekt i vjedhjes mund te jete vetem pasuria e tundshme. Per te ekzistuar vjedhja pasuria duhet te jete e huaj. Nese sendi nuk eshte ne pronesi te askujt apo nese eshte i braktisur atehere nuk behet fjale per vjedhje. Lidhur me fajesine kjo veper mund te kryhet vetem me dashje. Nese kryesi ia kthen pasurine e personit te

---

<sup>6</sup> Ligji ndërkombëtar penal



demtuar para se te filloj procedura nda tij, ligji e ka parapare qe ai person mundet edhe te lirohet.<sup>7</sup>

Vjedhja është ajo që vjedhësit bëjnë: marrja e gjërave nga njerëzit e tjerë. Per shembull një vjedhës banke i vjedh paratë, një plackites bene grabitje ne lokal etj.

Njerëzit gjithashtu përdorin vjedhje në mënyra të tjera. Nëse dikush harxhon kohën tuaj, mund të thuash se po vjedhin kohën tuaj. Një dyqan me shitje mund të thotë: "Çmimet tona janë një vjedhje!" Në baseball, një kontrabandist mund të vjedhë një bazë. Kur ju shihni vjedhur , mendoni "të marrë".

Për vjedhje që ndodhin, duhet të plotësohen tre kushte: (1) mallrat duhet të hiqen nga posedimi i një tjetri pa pëlqimin e pronarit; (2) mallrat jo vetëm që duhet të merren, por edhe të "largohen", një kërkesë që është shumë formaliste dhe është e kënaqur me çdo lëvizje të të gjithë objektit, sado e lehtë; dhe (3) duhet të ketë një qëllim për të vjedhur, i cili zakonisht përkufizohet si një qëllim për të privuar pronarin përgjithmonë nga prona e tij.<sup>8</sup>

Huazimi i paautorizuar i pronës së tjetrit nuk është vjedhje nëse ka një qëllim për kthimin e pronës, as vjedhje e kryer nga dikush që merr mallra në besimin e gabuar se ata janë pronë e tij.

Kjo veper kryhet në rrethana të dhunës dhe përfshin zbatimin apo kërcënimin e forcës për të kryer vjedhjen ose për të siguruar arratisjen. Si qe e kemi vepren penale grabitja qe ndodhe ne forma te ndryshme. Dënimi për grabitje zakonisht është më i rëndë se ai për vjedhje tjera nga shkakut se kemi me shume grupe te personave qe bashkepunojne per realizimin e saj.<sup>9</sup> Shumë kriminologëve konsiderojnë statistika mbi grabitje të jetë një ndër treguesit më të mirë të përgjithshëm të krimit normën, sepse në krahasim me vjedhje apo vjedhjet viktimat kanë më shumë gjasa për të raportuar atë në polici dhe policia kanë më shumë gjasa për të regjistruar atë në statistikat e tyre zyrtare.

---

<sup>7</sup> Van den Haag, Ernest (1978). Ndëshkimi i kriminelëve: në lidhje me një pyetje shumë të vjetër dhe të dhimbshme . Librat themelore. ISBN 0-8191-8172-2 .

<sup>8</sup> Fletcher, George P. (1998). Konceptet themelore të së drejtës penale . Oxford University Press. ISBN 0-19-512170-8 .

<sup>9</sup> LIGJ Nr. 7895, datë 27.1.1995 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË1 (i përditësuar)

Vjedhjet munde te percaktohen ne llojeshmeri te ndryshme si, thyerja dhe hyrja e objekteve të një tjetri me qëllim për të kryer një krim brenda. Në ligjin e përbashkët angelez, vjedhje përbëhej nga thyerja e një banese natën për të kryer një krim, dhe një shkelje e veçantë eshtëpitë e mbuluara të përfshira ditën.

Megjithatë, në shekullin e 21-të, termi “vjedhje” ne përgjithësi u aplikuan për thyerje të kryera në çdo orë të ditës dhe në çdo strukturë, automjet apo anije të caktuar. Edhe pse motivimi i më të vjedhësve është vjedhje, qëllimi për të kryer vepra të ndryshme të tjera konverton një shkelje në një vjedhje. Për shembull, është e mundur të kryhet vjedhje me qëllim të përdhunimit .

Sistemet ligjore të bazuara në ligjin e zakonshëm tradicionalisht dallohen midis vjedhjes (marrja pa pëlqimin) dhe mashtrim (marrja me pëlqimin përmes mashtrimit), një dallim i ruajtur ende në shumë juridiksione.

Sidoqoftë, të dy krimet konsiderohen si të përjashtuara reciprokisht dhe përgjithësisht pranohet se një krim mund të përfshijë vjedhje dhe mashtrime (p.sh. vjedhjet dhe shitjet e mëvonshme të një automjeti). Vjedhja gjithashtu dallohet zakonisht me përvetësim , në të cilin shkelësi transporton mallra, posedimi i të cilave i është besuar ligjërisht. Ashtu si me mashtrimet, vjedhja është një krim i veçantë nga përvetësimi, por dy veprat nuk janë ekskluzive reciprokisht.<sup>10</sup>

Megjithëse shumë sisteme juridike vazhdojnë të ndajnë vjedhjet në kategori, disa juridiksione, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara , i kanë konsoliduar ato nën titullin e përgjithshëm të vjedhjes, duke i lënë gjykatës shkeljen e një vepre penale në kategorinë e duhur. Përveç kësaj, shumë sisteme ligjore kanë shtuar kategori të reja të vjedhjes për t'u marrë me format moderne të pronës që nuk mund të jenë fizike apo të prekshme .

"Cybertheft ", për shembull, përfshin përdorimin e një kompjuteri për të privuar një person tjetër nga prona ose të drejta, si kur një kriminel fiton qasje të paautorizuar në kompjuterin e një banke për të transferuar paratë nga llogaritë e njerëzve të tjerë ( krimin kibernetik ).<sup>11</sup>Sistemet ligjore gjithashtu kanë modernizuar statutet e tyre për të mbuluar vjedhjen e pronës intelektuale ( ligjin e pronësisë intelektuale ). Për shembull, në vitet 1990 Kina ka miratuar një numër ligjesh, civile dhe penale, kundër shkeljes së

---

<sup>10</sup> <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/leksione/veprat-penale.html>

<sup>11</sup> <https://www.britannica.com/topic/theft>

të drejtave të autorit , markave tregtare , patentave dhe llojeve të ndryshme të dizajnit, duke përfshirë qarqet e integruara .<sup>12</sup>

## 1.2 Karakteristikë e veprave penale te vjedhjes

Veprat kundër pasurisë që kemi të bëjmë me vjedhje e ndryshme si karakteristike paraqitet, prona paraqitet si objekt themelor i vetëm mbizotërues i mbrojtjes, ndërsa te veprat tjera penale, ajo paraqitet si objekt i mbrojtur së bashku me ndonjë objekt tjetër, me ç'rast ky objekt tjetër ka domethënie primare.<sup>13</sup>

Karakteristikë tjetër është ndryshimi dhe mënyrat dhe mjetet e kryerjes së veprave penale te vjedhjes dhe format e shfaqjes, por esenca e tyre ka mbetur e njëjtë.

Karakteristikë themelore e numrit më të madh të veprave kundër pasurisë, është përvetësimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore. Këto janë të gjitha ato vepra penale, të cilat veçori konstituive është qëllimi i përvetësimit të dobisë pasurore të kundërligjshme. Veprat e tilla janë psh. vjedhjet, vjedhjet e rënda, vjedhjet grabitqare, shantazhi etj. Këto vepra penale kryhen vetëm me qëllim që ta mbajë në posedim të vetin, por pa pasur qëllim të përvetësimit.<sup>14</sup>

Ekzistojnë vepra penale, të cilat nuk ekziston asnjëri prej këtyre qëllimeve të përmedura, vetëm qëllimi i marrjes së sendit të huaj për shkak të shërbimit dhe përdorimit për qëllimet për të cilat është destinuar, në mënyrë që pas kësaj përsëri t'i kthehet pronarit të mëparshëm.

Vepra e tillë janë të njohur edhe nga e drejta penale romake si shfrytëzim i kundërligjshëm i sendit pa qëllim të përvetësimit. Anën subjektive të të gjitha veprave penale kundër pasurisë e paraqet paramendimi, sepse përveç qëllimit si karakteristikë subjektive, këto vepra mund të dallohen edhe sipas disa rrethanave objective.<sup>15</sup> Ato kryhet nga motivet e ndryshme që vijnë nga kryesit, si nga kushtet ekonomike dhe

---

<sup>12</sup> Ligjin e pronësisë intelektuale, Charles Donahue, Gregori Aleksandër

<sup>13</sup> E drejta penale, Borislav Petroviq, SARAJEVË / PRISTINË 2006 FSK/S - 14/06

<sup>14</sup> Encyclopaedia Britannica, viti 2019, inc

<sup>15</sup> H.Abadinsky., "Organized Crime "(Seventh edition), 2003;

sociale, arsimimi i ulet, qellimi per arritje te pasurise nga ana e kryreseve gjithashtu dhe nga ana psikike e kryreseve qe ndodhin ne moment e jetes dhe ngjarjes.

Keto vepra kane karaktersike se kryhet me ane te dhunes dhe kercentimit, por sipas dispozitave penale dhe ne menyre direkte si dashje, dhe shume here nga pakujdesia e kryreseve nga mosinformimi i pasojave te saj.

## **2.0 Aspektet krahasuese ne legjislacionet e vendeve te tjera**

### **2.1 Veprat penale te vjedhjes ne R.Kosoves**

Veprat penale kundër pasurisë konsid<sup>16</sup>erohen si ashtuquajturë kriminaliteti klasik.Mbrojtja e pasurisë, e cila përfshinë jo vetëm mbrojtjen e sendeve por dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave pronësore,në masë më të madhe realizohet me dispozitat e drejtës civile dhe ekonomike,ndërsa me masa penalo juridike vetëm ne shteti kur deri të rrezikimi i pasurisë ka ardhur me përdorimin e dhunës kërcënimit mashtrimit dhe veprimeve tjera të rrezikshme. <sup>17</sup>

Sipas Kodit Penal te RK te nenit 252 e definojme ne kete menyre vepren penale te vjedhjes; Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme,më qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë apo peronin tjetër, dënohet. Sipas këtij përkufizimi ligjor,objekti mbrojtës,të vepra penale e vjedhjes është pasuria e luajtshme e personit tjetër. Pra këtu ligjdhënësi nuk e përdorë termin (sendin)por e përdorë termin pasurinë e luajtshme e cila mund të shprehet në forma të ndryshme.(përveç sendeve në formë materiale, termi pasurinë e luajtshme,për shembull mund përfshi energjinë elektrike, impulset telefonike e tjera).<sup>18</sup> Edhe pse të vepra penale e vjedhjes është parapa dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri tri vjet (ligjdhënësi) e ka parapa dhe tentativën e vjedhjes ,në rastet kur ndërmerret veprimi i kryerjes por nuk përfundohet ose nuk shkaktohet pasoja. Po ashtu, ligjdhënësi të vepra penale e vjedhjes së ka parapa mundësin e lirimit nga dënimi ne rastet kur kryerësi pasurinë e vjedhur e kthen para se të jetë njoftuar se ndaj tij ka filluar ndjekja penale.

---

<sup>16</sup> Kodi penal I Repbulikes se Kosoves, fq.97, 13 Korrik, Prishtine,

<sup>17</sup> Komentar i Kodit penal- Akademik, Kosove 2010,

<sup>18</sup> Ismet Salihu, “ E Drejta Penale “ - Pjesa e Posaçme , Prishtine, 2014;

## 2.2 Veprat penale te vjedhjes ne R.Shqiperise

Ne kreun III te Kodit Penal te Shqiperise I definojmene kete menyre, Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Ne seksionin e vjedhjes se<sup>19</sup> pasurise qe paraqitet ne neni 134 Vjedhja e (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012), nenkuptojme se vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet. Ne nenin 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën (Shtuar fjalë me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013) .

Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Ne Kodin e Repbulikes se Shqiperise I kemi keto lloje te veprave penale te vjedhjes qe do I permendemi me poshte:

Vjedhja e bankave dhe arkave, Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike. Vjedhja e rrjetit të komunikimeve, Vjedhja e veprave të artit e kulturës , Trafikimi i veprave të artit , Vjedhja, Vjedhja me armë , Vjedhja me pasojë vdekjen, Trafikimi i mjeteve motorike, Sigurimi i mjeteve për vjedhje.

Gjithashtu e kemi dhe mashtrimin ne kete Kod por I ndare ne seksionin e II, ne neni 143 ku thuhet se : Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit, për vete ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashtrimit dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet. 96 Kur vepra, ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Vjedhja e pasurisë dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim

---

<sup>19</sup> Kodi penal I Republikës së Shqipërisë, Miratuar me Ligjin të dt.27.1995, ribotimi 2014 Dhjetor, fq.134

nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.  
E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet

### 2.3 Veprat penale te vjedhjes ne R.Maqedonise

Veprat penale te vjedhje ne Maqedoni perfshihen ne Kod Penal ne Kreun XXIII, si Vepra Penal kunder Pasurise , Vjedhja definohet ne nenin 235 te ketij Kodi, ngjajshmeri ka ne shume pika si me Kodin e Kosves qe e parasheh kete veper penale ne dispozitat e saj.<sup>20</sup>

Ne parag.1 te nenin 235 Vjedhja definohet ne kete menyre.:<sup>21</sup>

Ai I cili nga tjetri do te merr send te luajtshme me qellim qe ne menyre te kunderligjshme ta pervetesojte ate, do te dënohet me gjobe ose me burgim deri ne tre vjet.

Parag.2 thuhet nese vlere e sendit te vjedhur eshte me vogel dhe kryeresi ka shkuar kah qe ta pervetesojte sendin me asi vlere, do te dënohet me gjobe ose me burgim deri ne nje vjet.

Parag.3 me denimin nga parag.1 te ketij neni do te dënohet edhe kryeresi qe do te merr dru nga pylli I huaj sasia e te cileve eshte me madhe se nje meter kub me qellim per pervetesim te kunderligjshem.

Parag.4 tentim per veprat nga parag.1,2 dhe 3 eshte I ndeshkueshem,

Parag.5 ndjekja per vepren nga parag.2 te ketij neni ndermerret padi private.

Ne republiken e maqedonis sipas Kodit Penal hyjne keto vjedhje:

Vjedhja e rende, Grabitja, Vjedhja grabitqare, Fshehja, Te sherbyerit (sherbimi), Marrja e sendeve te huaja, Marrja e automjetit, Demtimi I sendeve te huaja, Demtimi I te

---

<sup>20</sup> Vllado Kambovski&Ismail Zejneli, Drejta Penale - Pjesa e pergjithshme –Tetove, 2018;

<sup>21</sup> E drejta penale ne Maqedoni, Afrim Osmani, 2014

drejtave te huaja, Ndertimi I paligjshem, Mashtrimi, Mashtrimi I bleresve, Demtimi dhe hyrja e paautrozuara ne sistemin kompjuterik, Mashtrimi kompjuterik, Keqperdorimi I besmiti, Falementimi I rrejshem, Shantazhi, Fajdexhilleku, Pendimi I vepres se krijuar etj.

Keto vepra kryhet ne menyra te ndryshme qe do I numerojme disa:

Keto munden te kryhen me thyrje ose me dhune ne hapesirat e mbyllura, me pengesa te medha, bashkepunimi I shume personave te bashkuar shkak te kryrjes se vjedhjes, ne menyre te paturpshme, vjedhje e senevde me vlere me permasa te medha, ne keto vepra perdoret forca dhe kercenimi I drp qe e sulmon ndaj jetes app trupit te tjeterkujt, pervetesim I kunderligjshem I sendit, shkaktimi I lendimeve te renda trupore e rende, perdorim I arme zjarri etj.

Kryeres mundet te jete gjdo person fizik dhe juridik ne kryrjen e ketyre veprimeve, ajo behet me veditje dhe dashje te drejtperdrejt. Qellimi I vjedhjes eshte pervetesimi I sendit te huaj nen menyre te kunderligjshme.

Denimet qe aplikohen per keto vjedhje jane me burgim e cila zgjate prej 3,5 deri 10 vjet dhe gjithashtu me gjobe e cila n'varet prej peshes se vepres penale dhe sic e parasheh ligji.

## **Kapitulli i II**

### **Veshtrim penale te vjedhjes sipas legjislacionit penale te republikes se Kosoves- veshtrime hyres**

#### **1.0 Veshtrim historic per veprat penale e vjedhjes ne legjislacionine e Republikes se Kosoves**

Përcaktimi i nocionit të veprës penale është një ndër detyrat kryesore të legjislacionit dhe të shkencës së drejtës penale. Përkatësisht, përcaktimi i nocionit të veprës penale, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale, janë tri çështje kryesore të cilat i shqyrton e drejta penale. Në fakt vepra penale është manifestim i mospajtit të personit të caktuar me normat që gjenden në fuqi<sup>22</sup>.

Nocioni i veprës penale është përcaktuar në nenin 6 të KPPK, në të cilin thuhet: “Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.”<sup>23</sup>

Nga nocioni i veprës penale i përcaktuar me nenin 6 të KPPK, del se vepra penale përbehet prej këtyre elementeve:

- Veprimit të njeriut,
- Kundërligjshmërisë,
- Përcaktueshmërisë se veprës penale me ligj ,
- Përgje<sup>24</sup>gjësisë penale të kryesit(fajësisë).

Pra për t’u konsideruar një vepër si vepër penale e cila vlen edhe për veprën penale të vjedhjes ajo duhet kumulativisht të plotësohen të gjitha këto elemente. Këto elementë përcaktojnë një figurë të përgjithshme të veprës penale, dhe nëse mungon njeri prej këtyre elementeve, vepra penale nuk mund të ekzistojë.

---

<sup>22</sup> R.Lukiq. „ Metodologjia e se drejtës”, Bg., 1995

<sup>23</sup> Prof, Dr. Ismet Salihu, “ E Drejta Penale “- Pjesa e Posaçme , Prishtine, 2014;

<sup>24</sup> E drejta penale-pjesa e pergjithshme, Dr.Prof.Ismet Salhiu, botimi2003,ribotimi 2012, Prishtine



Elementët themelore të veprës penale mund të ndahen: ne elementet objektive dhe subjektive.<sup>25</sup>

Elementet objektive të veprës penale janë: Veprimi i njeriut, Kundërligjshmëria, Përcaktueshmëria e veprës penale në ligj. Elementi subjektiv i veprës penale është përgjegjësia penale e kryesit (fajësia).

Veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë në të ashtuquajturin kriminalitet klasik dhe janë të njohura edhe me ligjet penale më të vjetra edhe tek ne kemi definuar për këto vepra penale. Kështu që me vepra penale të vjedhjes sipas dispozitave penale nenkuptojmë vepra penale të vjedhjes është përvetësimi i qëllimshëm kundërligjor i pronës së luajtshme, e kryer me qëllim të përfitimit.

Vepra penale e vjedhjes, në Kodin Penal të RK është inkriminuar.

1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë, e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Pra, vepra penale e vjedhjes, definohet si marrje e pasurisë së huaj (e sendeve të luajtshme) me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të saj për vete, apo personin tjetër. Në këtë mënyrë është dhënë koncepti i përgjithshëm i vjedhjes, i cili përfshinë të gjitha elementet të cilat janë të përbashkëta për të gjitha format e kësaj vepre penale, si veprimi i marrjes së sendit të huaj i luajtshëm, si objekt i veprimit dhe qëllimit të kryerësit të veprimit që për vete, apo për personin tjetër të përvetësojë dobinë pasurore të kundërligjshme<sup>27</sup>.

Nëse marrja e pasurisë së huaj, nuk është bërë me qëllim të përvetësimit, atëherë mu<sup>28</sup>nd të bëhet fjalë për vepra penale të marrjes së pasurisë së huaj të luajtshme. Pasuria e cila është objekt i vjedhjes, duhet të jetë e luajtshme. Me shprehjen pasuri e luajtshme, duhet

---

<sup>25</sup> Puhani, Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1989,

<sup>26</sup> E drejta penale, Prof. Borisllav Petroviq, botimi 2006, fq. 30, Sarajevë, Prishtinë

<sup>27</sup> Prof. Dr. Sahiti, Ejup, Psikologjia gjyqësore, Prishtinë, 2007,

<sup>28</sup> Kodi penal i Republikës së Kosovës, fq. 92, botimi 14 Korrik 2012, Prishtinë

nënkuptuar të gjitha sendet të cilat mund të barten prej një vendi në vendin tjetër, pa e dëmtuar substancën e tyre.

Andaj, në të drejtën penale nocioni i pasurisë së luajtshme është më i gjerë, se nocioni i pasurisë së luajtshme në të drejtën civile. Kështu, disa sende të cilat në të drejtën civile konsiderohen të paluajtshme për shkak se u takojnë gjërave të paluajtshme, psh. Pajisjet e shtëpisë (radiatorët, tjegullat, vaska bojleri etj.) në të drejtën penale konsidohen sende të luajtshme. Të gjitha ato sende të cilat mund të çmontohen, në të drejtën penale konsiderohen sende të luajtshme.

Kryerës i veprës penale të vjedhjes mund të jetë çdo person.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje. Krahas dashjes, për t'u konsideruar se ekziston vjedhja, marrja e sendit huaj duhet të kryhet me qëllim të përvetësimit të pasurisë, në mënyrë të kundërligjshme si : Tentim vjedhja, gjithashtu është e dënueshme.<sup>29</sup>

Veprat penale të vjedhjes kundër pronës private dhe shoqërore të njohura nga praktika kriminalistike, kryesisht janë këto: vjedhje të banesave, të shtëpive, vjedhje e çan<sup>30</sup>tave, vjedhje me rastin e marrëdhënieve seksuale, vjedhje të rrymës elektrike, vjedhje të motoçikletave, të magazinave, vjedhje të kafshëve, të shpezëve, vjedhje të automjeteve, vjedhje në automjete, vjedhje ngas xhepat etj.

### 1.1 Kuptimi dhe karakteristikat e vjedhjes

Si karakterstike themelore e numrit më të madh të veprave kundër pasurisë, është përvetësimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore.<sup>31</sup>

Këto janë të gjitha ato vepra penale, te të cilat veçori konstituive është qëllimi i përvetësimit të dobisë pasurore të kundërligjshme. Veprat e tilla janë psh. vjedhjet, vjedhjet e rënda, vjedhjet grabitqare, shantazhi etj.

---

<sup>30</sup> Kodi I procedurës penale të Republikës së Kosovës, 28 dhjetor 2012, Prishtinë

<sup>31</sup> Sahiti Ejupi&Ismail Zejneli, “ E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Kosovës” Prishtinë, 2017;

Te disa vepra penale të këtij kapitulli (veprat penale kundër pasurisë) kryhen vetëm me qëllim që ta mbajë në posedim të vetin, por pa pasur qëllim të përvetësimit

Ekzistojnë vepra penale, te të cilat nuk ekziston asnjëri prej këtyre qëllimeve të përmedura, vetëm qëllimi i marrjes së sendit të huaj për shkak të shërbimit dhe përdorimit për qëllimet për të cilat është destinuar, në mënyrë që pas kësaj përsëri t'i kthehet pronarit të mëparshëm. Vepra e tillë është e njohur edhe nga e drejta penale romake si shfrytëzim i kundërligjshëm i sendit pa qëllim të përvetësimit. Anën subjektive të të gjitha veprave penale kundër pasurisë e paraqet paramendimi, sepse përveç qëllimit si karakteristikë subjektive, këto vepra mund të dallohen edhe sipas disa rrethanave objektive.<sup>32</sup>

Veprat penale kundër pasurisë, konsiderohen forma të rënda, të kualifikuara në rastet kur kryhet me dhunë apo me kanosje, duke përdorur armë apo mjete të rrezikshme, duke vepruar posaçërisht në mënyrë të rrezikshme dhe të vrazhdë etj. Me dispozita të KPK-së, është inkriminuar mundësia e lirimit nga dënimi, nëse kryerësi i veprës penale e kthen pasurinë e përvetësuar, ose e ka në posedim para se të jetë njoftuar për fillimin e procedurës penale.

Si karakteristik kemi te keto vepra penale sipas Kodit Penal të RK, dhe drejtes penale është dhuna dhe kanosja për shkak të arsyes, se vepra e kryer nën ndikimin e dhunës se papërballueshme ose vepra e kryer nuk është e papërballueshme nuk është vepër penale vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.

Por nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e dhunës së përballueshme apo kanosjes së përballueshme,<sup>33</sup> dënimi mund të zbutet vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente. Kushdo që përdor dhunën ose kanosjen sipas KPK në paragrafin 1 dhe 2 ,të këtij neni konsiderohet kryes i veprës penale.

Por në këto vepra penale ekziston edhe urdhrat nga lartë , që ndodhe në rastin se kur vepra penale është kryer nga një person në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori,

---

<sup>32</sup> Vesel Latifi, " Politika Kriminale" , Prishtinë, 2003

<sup>33</sup> Latif, Veseli, Kriminalistika, Prishtinë, 2011.

qoftë ushtarak ose civil, kryesi nuk lirohet nga përgjegjësia penale, përveç kur personi ka qenë i detyruar ligjërisht që t'i bindet urdhrit të tillë, ose personi nuk e ka ditur se urdhri i tillë ka qenë i paligjshëm; dhe urdhri i tillë nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm që ndodhe ne vendin tone si Mashtrimi, Mashtrimi për shërbime komunale etj. Urdhrat për të kryer gjenocid ose krime të tjera kundër njerëzimit janë të paligjshëm në të gjitha rrethanat.<sup>34</sup>

Vepra penale e vjedhjes sipas KPK, kryhet edhe në bashkëpunim si bashkëkryreja, shtytja, ndihma, bashkim kriminal. Kjo veprë mundet të ndodhe edhe në tentativa kur kemi të bëjmë me kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprën penale.

Marrja e sendit të huaj<sup>35</sup> të luajtshëm, paraqet veprë penale vetëm nëse marrja është kryer me qëllim që përmes përvetësimit të sendit t'i sigurojë vetes apo tjetrit, dobi të kundërligjshme pasurore. Nëse marrja e sendit nuk është kryer me qëllimin e përmendur nuk ekziston vjedhja, por mund të ekzistojë ndonjë veprë tjetër penale psh. marrja e automjetit. Kryerës i veprës penale të vjedhjes mund të jetë çdo person.

Karakteristik tjetër është që<sup>36</sup> ajo kryhet nga çdo personi moshës që nga i mituri, madhori dhe i moshuari i karakterizon gjitha kategorit e moshave, ajo kryhet edhe për shkaqe ekonomike, gjendja sociale, dhe arsimim i ulët i kryesëv.

Por në kohën e fundit ajo po përdoret edhe nga njerëzit me kualifikime të larta arsimore duke përdorur mënyra të ndryshme deri të arritja e sukseshme e ndonjë prej veprave penale të vjedhjes.

---

<sup>35</sup> E drejta penale – pjesa e posaqme, Dr. Ismet Salihu, botimi I dyte, 2014, Prishtinë

<sup>36</sup> E drejta penale, Prof. Borislav Petroviq, botimi 2006, fq. 33, Sarajevë, Prishtinë

## 1.2 Objekt i vjedhjes

Ne drejten penale nenkuptojme te mirat juridike qe jane te mbrojtura me drejten penale qe nenkuptojme qe veprat penale jane te drejtuar kunder te mirave apo vlerave te cilat jane te mbrojtur me sistemin juridik te nje vendi dhe me drejten nderkombetare.

Me fjale te tjera object i vepres penale eshte e mira juridike kunder ciles eshte e drejtuar vepra penale. Nocioni i vepres penale plotesohet me njohurit e objektit te vepres penale ngase vetem kur percaktohet objekti I vepres penale dhe te konstatohet se cka mbrohet me nje dipozite penale juridike ateher kuptohet kuptimi I asaj dispoizite ose veper penale.

Ne drejten penale si object I vepres penale konisderohen te mirat ose vlerat vitale t enjeriut , te nje populli t enje vendi dhe komuniteti nderkombetare qe kety hyjne( jeta e njeriut, intergriteti I tij turpor, lirite dhe drejta themelore te njeriut, qytetarit, siguria , paqja , barazia etjr.)<sup>37</sup>

Objekti I vepres penale ka qene e pranishme ne gjitha fazat e drejtes penale , si nga koha shoqerive me stabile dhe demokratike qe I ka mbrojtur sipas drejtees penale njeriun dhe lirit dhe drejta e tij, por dhe ne Kohen e peridhues shoqerore politike qe jane percjellur me kriza qe ka qene pjes steriliteti I rregullimit shoqerore dhe frika nga klasa sunduuese se po rrezikohet pushteti I tyre, behen pjese e objektit themelore I mbrojtjes penalo juridik.

Ne drejten penale njihen dy lloje te objektit te vepres penale si objekti pergjithshem dhe grupor.

Si object I pergjithshem- eshte teresi e te gjitha te mirave juridike qe jane te mbrojtur me drejten penale paraqesin object te pergjithsem te veperave penale<sup>38</sup>

Object grupor-eshte konkretizimi I objektit te peegjithshem te vepres penale, ajo perfshine disa objekte posaqeme qe jane te ngjashme mes vete.

Gjithashtu per tu ber object duhet te kemi Veprim qe do thote qe personi apo vleren tjetër juridike ndaj te cilit eshte ndermarr kryrjea me qe rast demtohet apo rrezikohet

---

<sup>37</sup> E drejta penal e pergjithshme. Prof, Ismet Salihu, botimi I katert 2010, Prishtine

<sup>38</sup> E drejta penale pjesa e posaqeme, Prof.Ismet Salihu, botimi dyte 2014, Prishtine

objekti qe mbrohet nga drejta penale . e mira apo vlera juridike ndaj te ciles eshte drejtuar vepra penale paraqet objektin e veprimit. psh te vepruar e spiunazhit, ku object veprimi paraqiten te dhenat secrete ushatarake, ekonomike- e te vjedhja –objekt I veprimit eshte sendi I huaj I tundshume, e te vrasja jeta e njeriut etjr.

Nga kjo qe e permendem me larte themi sipas drejtes penale pjeses posaqme object Ii vjedhjes jane sendet e luajtshme , sendet e luajtshme konisderohen sendet qe mund te barten prej nje vendi nje vendin tjeter pa u demtuar substance e tyre. Me veprim te kryrjes se vepres penale eshte e percaktuar si marrja e pasuris se huaj te luajshme, nga kjo del se veprimi mundet te kryhet ne qfardo menyre. Si menyre e veprimit sulumues dhe gramatik.<sup>39</sup>

Si object I vjedhjes duhet te jete pasuria e huaj, qe rezulton nga kjo se personi nuk mund ta vjedh pasurine e vet. Mirpo do te konisderohet se eshte e kryer vjedhja ne rastet kur merret pasurine e huja me qellim te pervetesimit edhe pse ajo pasuri nuk eshte e personit nga I cili vidhet, por I personit te trete. Nga kjo rezulton se eshte e mundur vjedhja e asaj pasurie e cila me pare ka qene e vjedhur. Per shembull A me pare e ka vjedhur nje veture nga personi B dhe pas nje jave personi C e vjedh po kete veture nga garazhi I personit A.

Me fjale tjera , mundet te vidhet sendi I cili me pare I eshte besuar, pervetesimi I sendit, perkatesisht pasurise se huaj qe ei eshte besuar kryersit nuk konsiderohet veper penale te vjedhjes , por veper penale e shperdorimit e parapare me dispozita tek neni 330 te Ligjit penale te RK.

Gjithashtu si object nuk mund te jen sendet e braktisuara apo sendet per te cilat nuk I dihet se kujt I takojne, por ato mundet te jene edhe dokumententet me cilat realizohet ndonje e drejte psh. E vjedhjes se karteles se bankes.

Duhet te theksojme se object I vjedhejs duhet te jete e luajtshme, qe nenkuptojme me pasuri e luajtshme te gjitha sendet te cilat mund te barten prej nje vendi ne vendin tjeter , pa demtuar substance e tyre.

---

<sup>39</sup> Komentari I Kodit Penla te Republikes se Kosoves, Prof, Ismet Salihu, Prof, Hilmi Zhitija, Prof. Hasan Fejzullahu, botimi 2014, Prishtine

### 1.3 Figura ligjore e veprës penale të vjedhjes

Përkundër faktit se termi figurë e veprës penale njihet që moti; edhe sot e kësaj dite është kontestuese se çka duhet nënkuptuar me këtë. Sipas mendimit të disa autorëve, me figurën e veprës penale duhet kuptuar tërësinë e elementeve themelore të veprës penale, ndërsa sipas mendimit të autorëve të tjerë, me termin figurë e veprës penale duhet nënkuptuar tërësinë e elementeve të posaçme të çdo veprës penale.<sup>40</sup>

Tani mbisundon mendimi se me figurën e veprës penale duhet nënkuptuar tërësinë e elementeve të veprës penale të caktuar, ngase çdo veprës penale i posedon elementet e veta të posaçme që e bëjnë të dallohet nga veprat tjera e cila e dallon prej veprave tjera penale. Si elemente e posaçme janë të cekura në dispozitë të normave penale juridike. Thënë ndryshe se figura e veprës penale duhet kuptohet ato elemente të caktuara të cilat duhet të shprehen në veprimin e njeriut për të konsideruar se është kryer vepra penale.<sup>41</sup>

Figura ligjore sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme veq e veq dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitë të caktuar penale juridike. Në vepra penale të vjedhjes sipas dispozitës nënartikullit 325 të ligjit penal të RK përbehet prej elementeve të posaçme si marrja e pasurisë së huaj të luajtshme me qëllim që me përvetësimin e saj të fitohet vetes apo tjetrit fitim pasuror në mënyrë kundërligjshme.<sup>42</sup>

Ku sipas elementeve të posaçme të figurës së veprës penale konkrete i referohet kohës apo vendit të kryerjes së veprës penale të vjedhjes, mënyrës apo mjetit me cilat kryhet vepra penale, vetive personale të kryesit, motivit etj.

Elementet e posaçme të veprës penale ndahen në elemente objektive dhe subjektive gjithashtu dhe themelore dhe plotësuese.<sup>43</sup>

---

<sup>40</sup> Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prof. Ismet Salihu, Prof. Hilmi Zhitija, Prof. Hasan Fejzullahu, botimi 2014, Prishtinë

<sup>42</sup> E drejta penale – pjesa e posaçme, Dr. Ismet Salihu, botimi I dytë, 2014, Prishtinë

<sup>43</sup> E drejta penale, Prof. Borislav Petroviq, botimi 2006, fq. 33, Sarajevë, Prishtinë

#### 1.4 Teorite ne lidhje me kryrjen e vepres penale te vjedhjes

**Ne shkencen** e drejtes penale njihen disa teori lidhur me ate se kur eshte kryer vepra dhe gjithashtu perfundimi I asaj vepres penale te vjedhjes. Do I permendemi disa nga teorite e kesaj vepre:

Teoria ablacionit

Teoria tedorise se ilacionit

Teoria aprehenzionit

Sipas teoris se ablacionit- (contrecatacio-prekje), konisderohet se eshte kryer vjedhja me faktin se eshte prekur pasuria, perkatesishte eshte transferuar prej nje vendi ne vendin tjeter

Sipas teoris se ilacionit, per tu konsideruar se eshte perfunduar vjedhja nuk eshte e mjaftueshme qe sendi te jete bartuar ose transferuar ne vend tjeter, por eshte e domesdoshme edhe te jete bartur ne vend te sigurt disponon me sendin e vjedhur.

Sipas teoris se aprehenzionit-( te kapet , te grabitet) vjedhja konisderohet se eshte e perfundur ne rastet kur sendi I vjedhur eshte ne posedim faktik te kryresit te vepres. Perkatesisht kur kryresi I vepres faktkishte disponon me sendin e vjedhur.<sup>44</sup>

Ne teori dhe praktiken gjyqesore eshte pervesuar teoria e aprehenzionit dhe vjedhja konsiderohen se eshte kryer ne rastet kur sendi I vjedhur eshte ndare nga pronari I saj I ligjeshem dhe eshte vene ne posedim faktik te kryresit te vepres penale te vjedhjes.

#### 1.5 Menyrat dhe koha e veprave penale te vjedhjes

Sipas mënyrës së kryerjes, dallohen veprat e rrëmbimit (vjedhja,vjedhja e rëndë, grabitja etj), veprat e përvetësimit (psh. shpërdorimi), veprat të cilat kryhen me përdorimin e forcës dhe kërcënimit (detyrimi,shantazhi), veprat të cilat kryhen me mashtrim apo shfrytëzim, gjegjësisht me keqpërdorimin e ndonjë rrethane (psh.mashtrimi, kontraktimi joproporcional)<sup>45</sup>

---

<sup>44</sup> E drejta penale- pjesa e posaqme, Prof. Ismet Salihu, botimi I dyte 2014, Prishtine

<sup>45</sup> E drejta penale, Prof. Borislav Petroviq, botimi 2006, fq, 33,Sarajeve, Prishtine



Veprat ne shkencen e se drejtes penale posaqerisht asaj doktorines gjermane I kushtohet rendesi percaktimit te nocionit te veprimit. kjo eshte e kuptueshme nga fakti se veprimi apo sjellja e caktuar e njeriut eshte nje nder elementet themelore e konstraktive te cdo veper penale ngase pa veprimi vepra penale muk kryhet nuk ekziston(nullum crimen sine actione)

Veprimi eshte kusht kryesore per kryrjen e vepres penale te vjedhjes, ndersa elementet tjera jane vetem attribute te tij te cilat I bashkohen ne nje teresi unike.<sup>46</sup>

Veprimi si elemente konstative shprehet tek veprat penale qe kryhen me veprim dhe mos veprimi te cilat vlejne edhe per veprat penale te vjedhjes si vepra te kryra me dashje, pakujdesia, tentative ose dhe forma te ndryshme te kryrjes se vepres penale te vjedhjes.

Si veprim ne drejten penale kuptojme gjitha sjelljet apo veprimet e njeriut qe manifestohen ne boten e jashtme dhe me cilat jane te percaktuara me ligje qe jane te ndaluar si vepra penale. Si psh. Tek marrja e sendit te huaj . Tek veprat penale te vjedhjes mundem te themi se ngjajne dhe me psiken dhe vullnetin e brendeshem te njeriut, siq jane mendimi. Dëshira, vendimi dhe qellimi I kryrjes se vepres penale , nuk munden te konsiderohen veprime ne kuptim juridik penalo dhe nuk ndeshkohen nese ato nuk manifestohen me boten e jashtme<sup>47</sup>.

Per tu konsideruar ni veprim duhet te jete I vullnetshum e cila vlen dhe per vjedhjen ngase veprimi I vullnetshum egziston kur veprimi cili eshte ndermarre dhe drigjuar nga ana e personit te vedijshe dhe ne baze te vullnetit te lire ka vepruar. Gjithashtu dhe veprimi me mosveprim si menyre e kryrjes se vepres penale duhet te jete I vullneteshem.

Me ane te veprave penale te kryreja me veprim apo siq quhen ndryshe delikte komsive cenohen normat penale juridike te cilat ndalojn veprimin e caktuar. Te cilat ndryshe I quajme norma prohibitive. Me rastin e kryrjes se vepres penale me veprimi personi vepron ne kundershtrim me normen qe e ndalon veprimin e caktuar (psh.cenohet norma qe e ndalon pervetesimin e sendi te huaj ose fitimin e atij sendit te menyre te ndaluar sipas dipozitave te parapara )

Tek veprat penale te vjedhjes te kryer me mosveprim ose siq quhen ndryshe delikte omsive kryhen me mosndermjarrjen apo abstenimin nga veprimi qe ka qen I detyruar ,

---

<sup>46</sup> E drejta penale e pergjithshme, Prof. Ismet Salihu, ribotimi 2010, Prishtine

<sup>47</sup> Kodi penal I Republikes se Kosoves, 13 korrik 2012, Prishtine

I obliguar ta nderrmarr. Sipas kesaj kuptojme qe veprat penale munden te kryhet dhe me qendrmin pasiv te njeriut ne rrethana te caktuara per shkak te qendrimit I cili shkaktohen pasoja te ndaluara ne boten e jashtme .

Psh. Kemi te bejme me vjedhjen te sherbimeve dhe mashtrim.

### **Koha e kryrjes se vepres penale te vjedhjes**

Zakonisht menjëherë pas ndërmarrjes së veprimi shkaktohet pasoja e veprës penale. Në këto raste, në të dr. penale nuk paraqitet kurrfarë problemi lidhur me përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale, ngase përputhen koha e ndërmarrjes së veprimit dhe koha e shkaktuarjes së faktorit.<sup>48</sup> Mirëpo, në praktikë ndodh që veprimi të ndërmerret në një kohë, kurse pasoja të shkaktohet në kohën tjetër, më vonë, psh. Te mashtrimi qe me ane te kesaj nenkuptojme qe kryesi I vepres I sjelle vetes apo personit tjetet dobi pasurore te kunderligjshem qe ndodhe si ne afazim ekonomik qe shkaktohen pasoja me vone , ndodhe dhe ne perdorimin e dokumentave te rrema , keqepedorimi I drejtave nga sigurimi social etjr.

Çështja e përcaktimit të kohës së kryerjes së veprës penale ka rëndësi të posaçme praktike. Kjo rëndësi konsiston në faktin së prej kohës kur konsiderohet së është kryer vepra penale varet se cili ligj do të aplikohet. Ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është ndërmarrë veprimi apo ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është shkaktuar pasoja. Mandej sipas kohës së kryerjes se veprës penale përcaktohet përgjegjësia penale e kryesit dhe shqiptimi i sanksioneve penale – varësisht prej asaj së a ka qenë personi i mitur i ri, i mitur i rritur, madhor dhe a ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Afati i parashkrimit fillon të ecë prej momentit të kryerjes së veprës penale dhe në fund, në disa raste koha e kryerjes së veprës penale është element konstituiv i figurës së veprës penale. Lidhur me përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale, në shkencën e së dr. penale dhe në kodin tonë penal është përvetësuar teoria e veprimit. Kështu, sipas kodit penal vepra penale konsiderohet së është kryer në kohën kur personi ka vepruar apo ka qene I detyruar te veproje pa marrparasyshe Kohen kur eshte shkaktuar pasojae.<sup>49</sup>

Sipas nenit 32 të KPPK, vepra penale konsiderohet se është kryer në kohën kur personi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë pa marr parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja. Në rastet kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, si kohë e kryerjes së veprës

<sup>48</sup> E drejta penale- pjesa e pergjithshme, Prof. Dr. Vllado Kambovski, Shkup, 2006

<sup>49</sup> Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikes se Kosoves, nr.19/Korrik 20012, Prishtine;

penale konsiderohet koha kur bashkëpunëtori ka vepruar e jo kur kryesi ka ndërmarr veprimin e kryerjes. Te veprat penale të vazhduara dhe kolektive, të cilat sipas natyrës së tyre përbehen nga shumë veprime, kohë e kryerjes së veprës penale konsiderohet e tërë koha gjatë së cilës janë ndërmarrë veprimet e posaçme që përbejnë figurën e këtyre llojeve të veprave penale. Te veprat penale permanentë, si kohë e kryerjes së veprës penale konsiderohet e tërë koha sa ka zgjatur gjendja e kundërligjshme

#### 1.6 Motivet e tyre ne kryerjen te veprave vjedhjes

Motivi është komponentë psikologjike e jetës shpirtërore e cila e shtynë personin të ndërmarrë veprimin e caktuar.

Motivi sikundër qëllimi, gjenden jashtë dashjes. Vepra penale konsiderohet se është kryer me dashje pa marrë parasysh se a është kryer me motiv të caktuar.<sup>50</sup>

Kur motivi nuk është paraparë si element konstituiv i veprës penale, ai merret si rrethanë rënduese apo lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Mirëpo në legjislacionin penal, disa vepra penale konsiderohet se ekzistojnë vetëm nëse janë kryer me motive të caktuara, p.sh. vepra penale vjedhja e rende , zjarrevenia, shantazhi etj.

Nëse këto vepra nuk janë kryer nga motivet e caktuara, atëherë është fjala për vepra tjera penale. Nga kjo mund të konkludojmë se në disa raste të parapara shprehimisht me ligj, motivi shfaqet si element konstituiv i veprës penale, e nëse motivi nuk është i paraparë si element kualifikues i veprës penale ai mund të merret qoftë si rrethanë lehtësuese apo rënduese me rastin e matjes së dënimit (neni 73 i KPRK). Tani me dispozitat e KPRK, nuk është paraparë si vepër e cilësuar vrasja nga motivet e gjakmarrjes, mirëpo vrasjet e tilla ndodhin shpesh në rrethanat kosovare, në këto situata me rastin e matjes së dënimit motivi do të merret si rrethanë rënduese.

Veprat penale të këtij kapitulli mund të sistemohen sipas motivit të kryerjes së tyre:<sup>51</sup> 1. Veprat penale të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme; 2. Veprat penale të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme; 3. Veprat penale të cenimit të të drejtave

---

<sup>50</sup> E drejta penale. Prof,Dr. Borislav Petroviq,Sarajeve. Prishtine 2006

<sup>51</sup> Bajrami, Arsim and Shala, Xhavit and Hasani, Fejzullah and Mushkolaj, Gjyljeta and Vokshi, Adem and Sejdiu, Suzana and Bexheti, Meleqe and Batalli, Mirlinda and Pepaj, Islam (2015) *Doracak për përgatitjen e Provimit të Jurisprudencës*

të huaja; 4. Marrja dhe shkatërrimi i sendit të huaj; 5. Veprat penale të keqpërdorimit; 6. Veprat penale të mashtrimit, shantazhit dhe detyrimit.

## **2.0 Disa nga llojet e veprat penale te vjedhjes sipas Kodit Penal te Kosoves –Pjesa e posaqme**

Veprat penale ne drejten penale në kapitullin XXVII, janë sistemuar veprat penale të cilat emërtohen vepra penale kundër pasurisë, kundër të mirave, ku përveç veprave klasike (vjedhja, vjedhja e rëndë, grabitja, vjedhja grabitqare...) janë edhe veprat penale të cilat tërthorazi e cenojnë pasurinë. Sipas disa njohësve të së drejtës penale, këto vepra penale është dashtë të ndahen në vepra penale kundër sendeve, kundër të drejtave pronësore dhe kundër pronësisë intelektuale

### **2.1 Kuptimi i vjedhjeve te rende**

Vepra penale e vjedhjes së rëndë, është përcaktuar me nenin 327 siç vijon: <sup>52</sup>

Paragrafi 1. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 KPK-së, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse: 1.1. Vepra është kryer duke kaluar, apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat sanduqet, apo hapësirat tjera të mbyllura, ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme.

Nenparg. 1.2. Kryerësi ka vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme, apo të vrazhdë.<sup>53</sup>

Nenpargarfi 1.3. Kryerësi ka shfytëzuar gjendjen e krijuar, si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera.

Nenpargarfi 1.4. Kryerësi ka shfrytëzuar paaftësinë, ose gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër.<sup>54</sup>

2. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 i KPK-së, ose paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet nëse;

2.1. Pasuria apo shërbimi i vjedhur ka vlerë mbi pesëmijë (5000) euro.

---

<sup>52</sup> Kodi Penal I Kosoves, Prishtine, 13 Korrik Prishtine;

<sup>53</sup> E drejta penale- pjesa e posaqme, Prof. Ismet Salihu, Prishtine, 2010;

<sup>54</sup> Komentari i Kodit penal- Akademik, Kosove 2010

2.2. Pasuria e vjedhur, shërben për qëllime fetare, ose është vjedhur nga ndërtesa fetare, apo ndërtesa tjetër, që shërben për mbajtjen e ceremonive fetare .

2.3. Pasuria e vjedhur ka vlerë kulturore, fetare, apo historike, ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike, është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur, apo e ekspozites publike, ose është monument apo objekt i natyrës nën mbrojtje<sup>55</sup>.

2.4. Pasuria është vjedhur nga varri.

2.5. Pasuria e vjedhur është armë.

2.6. Kryerësi ka pasur me vete armë, apo mjet tjetër të rrezikshëm

2.7. Kryerësi ka vepruar si anëtar i grupit. Vjedhja e rëndë është formë kualifikuese e vjedhjes, e cila ekziston kur vjedhja e zakonshme kryhet nën kushtet e veçanta, të cilat vjedhjes së zakonshme i japin formën (trajtën) e rëndë.

Këto rrethana, kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes, kohën e kryerjes, rrezikun e veçantë të kryerësit të veprës dhe vlerën e sendeve të vjedhura.

Në varësi të rrethanave të përmendura, KPSH përmend këto forma të vjedhjeve të rënda:

a) Vjedhje me thyerje, a vjedhje të kryera duke depërtuar a kaluar me forcë, ose duke hequr pengesat të tjera, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme që gjendet në hapësirat e mbyllura.;

b) Vjedhje të kryera në mënyrë posaçërisht të rrezikshme apo të vrazhdë,.

c) Vjedhje të kryera, nga ana e personit, i cili me vete ka pasur ndonjë armë apo mjet të tjetër të rrezikshëm për të sulmuar, apo për t'u mbrojtur.'

d) Vjedhje të kryer, nga ana e grupit, të cilët janë bashkuar për të kryer vjedhjen,.

e) Vjedhje të kryera, kur kryerësit kanë shfrytëzuar gjendjen e krijuar, si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera të ngjashme.

---

<sup>56</sup> Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikës së Kosovës, nr.19/Korrik 20012, Prishtinë;

f) Vjedhje të kryera, kur kryerësi ,apo kryerësit kanë shfrytëzuar paaftësitë, apo gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër.

g) Nëse sendi i vjedhur ka vlerë të madhe, ndërsa kryerësi e ka bërë vjedhjen me qëllim të përfitimit nga kjo vlerë.

h) Nëse sendi i vjedhur, shërben për qëllime fetare apo sendi është vjedhur nga ndërtesa fetare apo ndërtesa tjera që shëbejnë për mbajtjen e shërbimeve fetare

, i) Nëse pasuria e vjedhur, ka vlerë kulturore, fetare apo historike, ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike, artistike, apo është pjesë e koleksionit privat, të mbrojtur apo të ekspozitës publike,ose është monument natyral apo objekt i natyrës që është nën mbrojtje.

Si kryerës i këtyre veprave të rënda, mund të jetë çdo person, ndërsa në këndvështrimin e fajtorit është i nevojshëm paramendimi apo dashja direkte.

Secila nga mënyrat e shumta të kryerjes është karakteristikë edhe për nga gjurmët të cilat mbesin në vendin e ngjarjes, ndërsa gjetja e tyre dhe përpunimi profesional ka rol jashtëzakonisht të madh për identifikimin dhe zbulimin e kryerësit.

Gjatë zgjedhjes së objektit të sulmit, si dhe mënyrës së kryerjes, kryerësit mbajnë kujdes për një varg faktorësh të natyrës objektive dhe subjektive.

Faktorët objektiv janë niveli i sigurisë së objektit të sulmit (psh. lloji i mjetit të alarmit që shfrytëzohet), mundësia për t'iu afruar objektit pa u vërejtur, mundësia e ndonjë faktori të jashtëm (psh.trafik i dendur, afërsia e aeroportit etj) që të ndikojë në fshehjen e zhurmës e cila bëhet si mbulues i thyerjes dhe vjedhjes, përdorimi i mjeteve të nevojshme, i veglave dhe mjeteve të tjera, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e veprës penale.

Te kjo vepër penale, si figurë e veçantë është parashikuar edhe krijimi i krijimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për ta vjedhur pasurinë. Me krijimin e kushteve kuptohen: njohja e mjedisit ku ndodhet objekti i vjedhjes, e orarit të punës (fillimit dhe mbarimit) në një ndërmarrje apo institucion, vëzhgimi i largimit për në punë i personave të një shtëpie, mënjanimi i rojës së ndërmarrjes në kohën e kryerjes së vjedhjes, krijimi i situatës së simulimit, studimi i hyrjeve në banka private ose shtetërore, ku janë vendosur aparatura teknike të fshehta me qëllim që të nxirren jashtë përdorimit etj.

Me sigurimin e mjeteve materiale kuptohen: përgatitja e çelsave të dyerve të ndërmarrjeve ose shtëpive, levave të posaçme, e mjeteve për hapjen e kasafortave, përdorimin e automjeteve për transportimin e sendeve të vjedhura, studimi i vendeve për fshehjen e sendeve të vjedhura, paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, mjeteve teknike me qëllim të vjedhjeve të pasurisë.<sup>57</sup>

Në faktorë të natyrës subjektive bëjnë pjesë shkathhtësitë, të cilat i njohin dhe teknikat me të cilat i përdorin, shprehitë e fituara në kryerjen e veprave penale, përvojën e më hershme dhe veçantitë fizike. Poashtu anën subjekteve të të gjitha formave përmendura të vjedhjeve të rënda e bënë paramendimi.

Ai është i ndryshëm te disa forma, por krahas veçorive tjera të vjedhjes duhet të shihet ajo rrethanë e cila këtë formë të vjedhjes e bënë të rëndë (psh.shfrytëzimin e paaftësisë së ndonjë personi, që vjedhja të kryhet me thyerje etj.). Ndërsa kryerës i veprës penale, siç e cekëm më parë, mund të jetë çdo person.

## 2.2 Kuptimi i vjedhjeve të shërbimeve

Vjedhja e shërbimeve si vepër penale kundër pasurisë nuk ka ekzistuar në KPPK-në e shfuqizuar. Pra, vepra penale e vjedhjeve të shërbimeve, është e inkriminuar me KPK-në në fuqi. Vepra të tilla penale kryhen vetëm me dashje.

Vjedhja e shërbimeve është e inkriminuar në nenin 326, kapitulli XXVII (vepra penale kundër pasurisë).

Kjo vepër penale kryhet me anë të lajthimit, largimit apo mënyrave tjera kur siguron shërbime, për të cilat dihet se mundëson vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime, për të cilat dihet se mundëson vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla.

Çdo person që kryen këtë lloj vepre penale, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) Kur vepra penale nga paragrafi 1. kryhet me forcë, apo kanosje serioze, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre(3)vjet. Nëse vlera e shërbimeve të vjedhura

---

<sup>57</sup> E drejta penale pjesa e posaqme, Prof, Ismet Salihu, Prishtine, 2014

është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Për qëllime të këtij neni, shërbimet përfshijnë, por nuk kufizohet në transportimin, punën, shërbimet profesionale, teknike, apo mekanike, shërbimet e skiliftit, objektet për biseda telefonike, shërbimet e komunikimit ose telefonisë, ofrimi i ushqimit apo akomodimit, furnizimi me pasisje, vegla, vetura ose kampshtëpiza për përdorim të përkohshëm, furnizimi i pajisjeve për shfrytëzim ose qasja në sistemin e internetit, kompjuterik apo kabllor.<sup>58</sup>

Shërbim po ashtu përfshinë çmimin e hyrjes në evenimente sportive, zbavitëse, shfaqje ose ngjarje tjera që kanë çmim të hyrjes ose tarifë tjetër për pjesëmarrje. Largimi nga biznesi, hoteli apo restoranti pa ofruar për të paguar ose pa paguar për hotel, restorant apo shërbime tjera për të cilat kompensimi zakonisht paguhet pas pranimit të shërbimeve, është dëshmi se shërbimet janë pranuar me qëllim të shmangies së pagesës. Kryerësit e këtyre veprave penale ndiqen sipas detyrës zyrtare.

### 2.3 Vjedhja grabitqare

Vjedhja grabitqare në Kodin Penal është inkriminuar në këtë formë:

1. Kushdo që është zënë në befasi, në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdorë forcën ose kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej (3) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim trupor, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (10) vjet.<sup>59</sup>

---

<sup>58</sup> Kodi penal I Republikës së Kosovës, 13 Korrik Prishtinë

<sup>59</sup> [http://www.igoar.com/Articles/37/Images/25-09-2015/178188\\_Elizabeta\\_Imeraj\\_VEPRAT\\_PENALE\\_KUNDEr\\_PASURISE-001-013.pdf](http://www.igoar.com/Articles/37/Images/25-09-2015/178188_Elizabeta_Imeraj_VEPRAT_PENALE_KUNDEr_PASURISE-001-013.pdf)



4. Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja,

Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Forma themelore e veprës penale vjedhje grabitqare është një nga veprat penale pronësore më të rënda, ndërsa format e rënda të saj, u takojnë veprave më të rënda penale në përgjithësi. Vjedhja grabitqare, është veprë penale e përbërë (komplekse) e cila përbëhet nga vjedhja dhe përdorimi i dhunës apo kanosjes.

Vjedhja grabitqare fillon me vjedhje dhe pasi që kryerësi është hasur në vjedhje, e përdor dhunën ose kanosjen me qëllim që ta mbajë sendin (pasurinë) e vjedhur.

Nga kjo rezulton, se vjedhja i paraprin dhunës. Konsiderohet se kryerësi është hasur në vjedhje, në rastet kur ka filluar kryerjen e vjedhjes, por nuk e ka përfunduar, apo kur ik me sendin e vjedhur, sepse edhe në këtë rast konsiderohet se nuk e ka përfunduar vjedhjen.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale është e nevojshme që të plotësohen këto kushte:

- Që kryerësi të jetë zënë (në befasi) në kryerjen e aktit të vjedhjes.
- Që të ketë përdorur forcën ndaj ndonjë personi, apo kanosjen që drejtpërsëdrejti do ta sulmoj jetën apo trupin e tij.
- Që forca, apo kanosja është përdorur me qëllim që sendi i vjedhur të mbahet.

Për dallim nga vepra penale e grabitjes (neni 329 i KPK), te e cila përdorimi i forcës i paraprinë vjedhjes, këtu vjedhja i paraprinë përdorimit të forcës, gjegjësisht këtu përdorimi i forcës është mjet për mbajtjen e sendit të vjedhur nga ana e kryerësit i cili është zënë në aktin e kryerjes së vjedhjes.

Karakteristikë qenësore e kësaj vepre penale është vjedhja, në të cilën kryerësi është zënë në befasi. Forma e kualifikimit të veprës penale të vjedhjes grabitqare si formë e rëndë.

Kualifikimi i veprës grabitqare si e rëndë, është përcaktuar duke marrur parasysh pasojat e shkaktuara (shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore) apo duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes (vepra penale është kryer nga grupi gjegjësisht shumë persona apo vepra penale është kryer me përdorimin e ndonjë arme apo mjete tjetër të rrezikshëm).

Pra, rrethanat të cilat i japin veprës formë të rëndë janë:

- shkaktimi i lëndimit të rëndë trupor ndonjë personi,
- kryerja e veprës në përbërje të grupit,
- kryerje e veprës me përdorim të armës apo mjetit tjetit tjetër të rrezikshëm.

Në paragrafin 4. të nenit 328 të KPK-së, është përcaktuar forma më e rëndë e veprës penale të vjedhjes grabitçare dhe ajo ekziston, kur gjatë kryerjes së veprës ndonjë person rezulton me vdekje. Kjo në të vërtetë, është një rast special i kualifikimit të vrasjes së kryer me qëllim përvetësimi, por me që këtu privimi nga jeta, paraqitet si mjet për sigurimin e veprës së kryer dhe lidhshmërisë së këtyre veprave, KPSH këtë rast e përcakton, si rast më të rëndë të veprës penale.

që ndonjë person me paramendim të privohet nga jeta me qëllim të mbajtjes së sendit i cili është objekt i vjedhjes grabitçare. Me këtë lloj, vepra kemi të bëjmë edhe nëse ndonjë person privohet nga jeta, duke u detyruar që të zbulojë se ku gjenden sendet, të cilat kryerësi dëshiron t'i marr apo mbaj, apo në raste kur këtë e bënë që të thyej rezistencen, të pamundësojë thirrjen e ndihmës etj. Kryerës i kësaj veprë penale, mund të jetë çdo person. Kjo formë e veprës penale mund të kryhet me dashje, vetëm me dashje direkte.<sup>60</sup>

## 2.4 Mashtirimi

Me ane te vepres penale te mashtrimi kryresi I kesaj vepre I sjell vetes apo personit tjeter dobi pasurore te kunderligjshme. Kjo veper penale eshte shume e shpesht e sidmos ne Kosove mbas luftes ,ne periudhen e clirimit ku qytetaret duke u mashtruar apo duke u vene ne lajthitje nga personat e tjere jane demtuar.

Mashtrimi kryhet ne afarizimin ekonomik qe dhe shkakton pasoja civile juridike. Ne legjislacionin penal rastet e mashtrimit me qellim te ndryshme , varesishte nga fakti se kushe kryen mashtrimin, ndajjt kujt kjo kryhet dhe ne cfare rrethana.<sup>61</sup>

Si vepra penale te mashtrimit i vecojme si ato kryhen me qellim te te perdorimit te dokumentave te rreme, prenzantimi I rrem dhe keqepedorimi I te drejtave nga sigurimi

---

<sup>60</sup> Elizabeta Imeraj, Artikulli VEPRAT PENALE KUNDeR PASURISE, 2015, Prishtine;

<sup>61</sup> Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikes se Kosoves, nr.19/Korrik 20012, Prishtine;

social qe kryhet duke simuluar semundjen etj. Keto vepra sipas parg.1 te Kodit penale – pjesa e posaqme thuhet se kete veper penale e kryen kushdo qe me ane te paraqitjes se rreme te fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qellim te perfitimit te kunderligjshem te dobise pasurore per veten apo personin tjeter ose per ti shkaktuar dem material personit tjeter, e mashtron apo vazhdon ta mbaj ne lajthim personin tjeter dhe me kete e nxit qe te kryej apo te mos kryej veprim ne dem te pasurise se tij apo te pasurise se personit tjeter.

Veprimi I kryrjes se kesaj vepre penale eshte percaktuar ne menyre alternative :

- a) Sjellja ne lajthitje e personit tjeter I cili ndermerr nje veprim ne dem te pasurise se vet apo ne dem te personit tjeter kryhet duke paraqitur fakte te rreme apo duke fshehur fakte....
- b) Mbajtja ne lajthitje nenkupton rastet kur tek subjekti pasiv per shkaqe te ndryshem ekziston lajthitja per rrethana te caktuar , lajthitje qe nuk e ka shkaktuar kryeresin por qe ruhet apo perforcohet dhe shfrytezohet nga kryeresi....

Vepra penale e mashtrimit mundet te kryhet edhe ne raste kur kryeresi e shfrytezzone padien ose mendjelehtesine e viktimes , keshtu qe kjo ekzistone tek kjo veper nese nje person me te meta psikike, I papergjegjshem I ka ne dore 500Euro dhe kryeresi I merr kete monedhe dhe ne vend te saj ia jep monedhen ne vlere prej 50Euro.

Lidhja kauzale e kesaj vepre duhet te qenderoje midis veprimit te sjelljes ne lajthitje apo mbajtjes ne lajthitje dhe veprimit apo mos veprimit te subjektit pasiv.

Sipas llojit dhe natyres veprimet e mashtrimi duhet te jene te natyres cilat jane te pershtatshme qe tjeterin ta sjellin qe ne dem te vetes apo te tjeterit te ndermarre apo te mos ndermarre nje veprim. Viktima me sjelljen e saj I shkakton vetes apo tjeterit dem pasurore, kjo I shkaktohet si personit fizik dhe juridik.

Object I kesaj vepre penale eshte pasuria e huaj ne te cilen bejne pjese edhe interest juridike pasurore. Kjo veper mundet te kryhet me dashje.

Forma me rende e kesaj vepre penale eshte parapare ne parg.2, e cila konsideron se ekzistone se ekzistone neseme kryerjen e kesaj vepre kryeresi realizon dobi pasurore te kunderligjshme ose shkaktone deme ne vlere prej 10.000Euro ose me shume. Si rrethane

kualifikuese e kesaje vepre penale eshte lartesia e fitimit te realizuar apo demit te shkaktuar.

Dhe gjithashtu ne Parg.3 parashihet forme e posacme te kesaj vepre e cila konsiderohet se kryhet nese qellimi I mashtrimit eshte perfitimi I dobise kunderligjshme eshte ndahe bankes , apo institucionit tjeter finaciare.

Denimi per kete veper penale te mashtrimit parashihet ne paragrafin1 denimi eshte me gjobe dhe me burgim prej tre muaj deri ne tre vjet, per vepren nga parg.2 dhe 3 me gjobe dhe me burgim prej gjashte muaj deri ne pese vjet, per vepren nga parg.4 me gjobe dhe me burgim prej nje deri ne pese vjet , per vepren nga par.5 me gjobe dhe me burgim prej tre deri ne 10 vjet dhe per vepren ne parg.6 me gjobe dhe me burgim deri gjashte muaj.

## 2.5 Fajdet

Kete veper penale , ne forma te ndryshme e parashohin shumica e legjislacioneve penale te shteteve aktuale.

Kete veper e parasheh edhe Kodi yne Penal I Kosoves qe sipas parg. 1, kete veper penale e kryen kushdo qe per vete apo personin tjeter pranon ose kontraktin nje shume dukshem joproportionale te pasurise ne kembim te sherbimit per personin tjeter , duke shfrytezuar gjendjen e rende financiare te personit te tille , gjendjen e rende te banimit, varferine , papervojen ose paaftesine per te gjykuar.<sup>62</sup>

Veprimi I kryerjes eshte percaktuar ne menyre alternative- marrja apo kontraktimi I perfitimit joproportional pasuror. Llojet e sherbimeve per cilat kryesi I kesaj vepre penale e realizon fitim pasuror joproportional jane te dhena e parase uha, dhena e ndihmes mjekesore apo te ndonje ndihme tjeter , kryrjen e ndonje pune, shtyrja e pageses se ndonje borxhi, ndermjetesimi qe te kryhet nje veprim ne dobi te subjektit pasiv etjr.

Si ne shtete tjera dhe ne Kosove kjo veper kryhet me ane te dhenies se hua me kamta shume te larta, mandje edhe me kamat 10% per cdo muaj, marresit e huave te ketilla, kur u ka ardhur afati I kthimit te borxhit me kamate nuk kane qene ne gjendje ta bejne keta jane kercenuar nga kryresi e ketyre veperave dhe kane qene te detyruar te shesin pasuri te patundshem me cmime ekstremishte te uleta.<sup>63</sup>

---

<sup>62</sup> Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikes se Kosoves, nr.19/Korrik 20012, Prishtine;

<sup>63</sup> Prof.Dr.Ismet Salihu, E drejta Penale pjesa e pergjithshme, botimi I dyte, 2003, Prishtine

Elementi kryesor i kesaj vepre penale eshte shfrytezimi apo me mire themi keqepedorimi I nfonje situate apo gjendje cilen kryeresit e shfrytezon per te arketuar etjr. Si viktime kesaj vepre penale gjendjet ne rrethana ne cilat ne nje menyre eshte I detyruar te kerkoje apo te pranoje sherbime ne kushte te atilla cilat ne aspektin finaciar jane menyren ekstreme te pavolitshme per te.

Kjo veper ekzistone ne gjendje te rende material e cila e detyron viktimen te marre hua para me kamata shume te larta , kushtet e renda te banimit te cilat e detyrojne te paguaje qira shume te shtrenjte per te mos mbetur ne rruge, rastet e semundjeve akute dhe te renda per mjekimin e te cilave paguan shuma te medha , rasti kur vje afati I kthimit te borxhit dhe shet pasurine shume me lire se vlera e saj etjr.

Kjo veper penale sipas Kodit Penal te Kosoves eshte mbuluar ne nje menyre eshte mbuluar edhe rasti I dhenies hua te parave me kamata te larta me c rast kryhet kjo veper penale, por pikerishte kjo veper qe kryhet me se shpeshti me rastin e dhenies hua ne Kodin Penal te Krocaise(neni233 par.2) dhe sipas Kodit Penal te Maqedonis ne nenin 260 par.2 dhe kodet tjera rajonit dhe me gjere parashihet kjo forme e kryrjes eshte e veqante , ne cilen thuhet se denohet si per formen themelore cdo personi I cili merret me dhenien e huase duke kontraktuar ftiim pasuror jopropocional.

Kjo veper konsiderohet se eshte kryer eshte perfunduar ne rastet kur me shfrytezimin e ndonjeres nga rrethanat e permendura per sherbimin e kryer merret. Te kjo veper eshte e mundur dhe tentativae cila ekziston ne rastet kur eshte kerkuar fitimi jopropocional por nuk eshte kontraktuar ende.

Kryeres mundet te jete cdo person per kete veper penale , kjo veper mundet te kryhet dashje, ku dhe dashja mundet te inkludon ne vete edhe vetedijen se merret apo kontraktohet fitim pasuror jopropocional ne rrethanat e siperpermenduar.

Denimet per kete veper penale parashihen denimi me gjobe dhe me burgim prej gjashte muaj deri ne pese vjet, tete vjet deri dymbedhjet vjet.

## 2.6 Uzurprimi i paligjshem i pronës së paluajtshme të huaj

Me shprehjen e pronës së paluajtshme duhet nënkuptuar sipërfaqen tokësore, pyjore, paraqet bregdetin dhe çdo lloj tjetër sipërfaqen tokësore. Objekt mbrojtës i kësaj veprë penale është

prona e paluajtshme e huaj apo një pjesë e saj, kjo pronë mundet të jetë private dhe shoqërore gjithashtu dhe shtetërore.<sup>64</sup>

Sipas paragrafi 1 kësaj veprë penale kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj.

Në vendin tone kryhet shpesh, e sidomos pas çlirimit të Kosovës u rrit në masë të madhe kjo veprë penale, në dhjetë e fundit janë uzurpuar me dhjetëra hektar të sipërfaqeve tokësore e

posaqerisht të tokës ndërtimore rreth rrugëve, që në kohën e sistemit socialist ishte e kooperativave, pronë shoqërore, kurse sot në sistemin e ri demokratike kësaj statusi e emërtojmë si pronë kombëtare, përkatësisht pronë shtetërore, të pronës së Kosovës.

Veprimi i kryerjes së veprës penale është përcaktuar pushtimi, uzurpim i pasurore të huaj të paluajtshme apo një pjesë të saj.<sup>65</sup>

Pushtim do të thotë okupim, uzurpim i pasurisë së paluajtshme dhe shfrytëzimi i saj. Pushtimi duhet të jetë i kundërligjshëm që do të thotë se nuk është sajuar në ndonjë bazë juridike si p.sh. Sipas lejes së organit kompetent për shfrytëzimin e paluajtshmerisë. Kundërligjshmeria është tipar i posaçëm i kësaj veprë penale që do të thotë se personi konsiderohet se e kryen këtë veprë nëse ka qënë i vetdijshëm se prona është e huaj dhe se për kundër kësaj ai e pushton dhe e shfrytëzon atë.

Kryesori i kësaj veprë penale mundet të jetë çdo person, vepra penale kryhet me dashje, ku dashja e inkludon në vetë vetëdijen lidhur me kundërligjshmerinë e veprimit të ndërmarr.

Denimet sipas kodit penal në nenin 332 parashihen:

---

<sup>64</sup> Gazeta Zyrtare, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr.19/Korrik 20012, Prishtinë;

<sup>65</sup> E drejta Penale-pjesa e përgjithshme, Prof.Dr. Ismet Salihu, 2012, Prishtinë

Ne paragrafin 1 se kushdo qe ne menyre te kunderligjsheme uzurprone pronen e paluajtshme te personit tjetër apo nje pjese te saj denohet me burgim me gjobe ose me burgim deri ne dy (2)vjet.

E ne par. 2 te ketiji neni patashihet se nese vepra penale nga par.1 kryhet ne nje apo me shume nga rrethant ne vijm : nese prona e paluajtshme e uzurpruar eshte pjese e pyllit te mbrojtur, parkut te mbrojtur apo pyllit tjetër me destinim te posacem, tokes ndertimore ose rruges; ose nese kryersi ka uzurpurar pronen e paluajtshme duke e ditur se prone e tille eshte e nenshtruar debimit me urdher te gjykates apo me me urdher ose vendim te ndonje organi apo institucioni tjetër public te themeleuar ne bazete ligjit te zbatueshem ne Republiken e Kosoves; do denohet me burgim prej tre(3) muaj deri tre(3) vjet.

Ne par.3 thuhet se kryesi denohet me burgim prej nje deri ne tre vjete , nese eshte denuar me pare per uzurpim te kunderligjshem te prones se paluajtshme ose nese eshte debuar prej prones se tille te paluajtshme me vendim te gjykates apo me urdher apo vendim te ndonje organi apo instutucioni tjetër te themeluar ne baze te ligjit te zbatueshem te Republikes se Kosoves.

### **3.0 Llojet e shqiptimit te sanksioneve penale për veprat penale te vjedhjes**

#### 3.1.Kuptimi i dënimit dhe karakteristikat e saj per veprat penale te vjedhjes

Pasi që dënimi është masa e reagimit të shoqërisë kundër kryerësit të veprës penale e cila është e përcaktuar si e tillë me rregullativën juridike , ajo duhet të kundrohet si dukuri unike material-formale .<sup>66</sup>

Me fjalë tjera nocioni i dënimit duhet të shpreh në të njëjtën kohë esencën e vet , detyrën shoqërore si dhe veqorit e veta juridike , kjo do të thotë në formën në të cilën paraqitetet<sup>67</sup>.

Duke u nisur nga uniteti I elementëve formal e material , denimi percaktohet si masë e detyruar e paraparë në ligj të cilën e shqipton gjykata ndaj personit penalisht të përgjegjshëm si kryes i veprës penale në funksion të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut si dhe vlerave tjera shoqërore të garantuara me kushtetutë dhe të drejtën mderkombëtare, gjegjësisht privimin dhe kufizimin e të drejtave të tyre( të kryesëve të veprave penale<sup>68</sup>).

Nga ky definim i nocionit të dënimit ,rezultojnë elementet themelore , apo të përgjithshëm të tij<sup>69</sup>:

- 1) Dënimi si masë e dhunshme paraqet një të keqe e cila e godet personin që ka kryer veprë penale e cila konsiston në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të tij ,
- 2) Dënimi duhet të ket qëllimin e caktuar që dëshirohet të arrihet me ekzekutimin e tij,
- 3) Dënimi duhet të jet i përcaktuar me ligj .Ky është parimi ligjshmërisë së dënimit Me të cilin u ofrohet garancion qytetarëve nga keqpërdorimet dhe arbitrariteti. Kjo do të thot se dënimi nuk mundë të përcaktohet me asnjë akt nënligjor përveqse me ligj;
- 4) Ekzekutimi i dënimit është në mvarshmëri nga ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryesit të saj. Dënimi nuk mundë ti shqiptohet personit I cili nuk e ka kryer veprën penale , apo nuk është penalisht I përgjegjshëm, apo që nuk është konfirmuar se ai është kryes i sajë,

---

<sup>66</sup> Puhan, Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1989

<sup>67</sup> E drejta penale pjesa e pergjithshme, Prof.Dr.Borisllav Petroviq, Sarajeve, prishtine, 2006;

<sup>69</sup> Vllado Kambovski&Ismail Zejneli, Drejta Penale - Pjesa e pergjithshme –Tetove, 2018



5) Dënimin mundë ta shqiptoj vetëm gjyqi sipas procedurës së përcaktuar me ligj . Kjo procedure duhet të garantoj rregullsinë e shqiptimit të dënimit<sup>70</sup>

Përveq elementëve themelore tek disa dënime paraqiten edhe elementët relativ të cilët kanë karakter jo të përhershëm, të elementëve variabil: 1) Dënimi duhet të jetë personal ashtu që duhet të godas vetëm kryesin e veprës penale e jo edhe personat tjerë në afërsi .Megjithatë përkundër përpjekjeve të vazhdueshme në përmbushjen e kësaj kërkesë , gati qdo dënim drejtpërdrejt godet edhe personat tjerë (anëtarët e familjes dhe të afërt tjerë);<sup>71</sup> 2) Dënimi duhet të jetë human që do të thotë njerzor, apo thënë ndryshe nuk guxon të jetë i përbërë (dënim) nga tortura mundëimi apo të sjellurit tjetër jo njerzor ndaj kryesit të veprës penale ; 3) Dënimi duhet të jetë i moralshëm qka don të thotë të mos e demoralizoi kryesin e veprës penale ; 4) Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të kryesit të sajë; 5) Dënim duhet të jetë i ndarë ashtu që mundë të shqiptohet në masë më të vogël apo masë më të madhe ,varësisht nga pasha e veprës penale , rrethanat në të cilat ajo është kryer dhe rrezikshmërisë së kryesit të veprës etj.

Llojet e dënimeve në të drejtën penale të Kosovës Ligji penal i Kosovës në nenin 35 parasheh dënimet në vijim <sup>72</sup>;

1] Dënimet kryesore,

2] Dënimet alternative dhe

3] Dënimet plotësuese.

Dënimet kryesore janë: Dënim me burgim afatgjatë, Dënim me burgim , Dënim me gjobë [ para] Dënimet alternative janë: Dënim me kusht, Gjysmeliria.

Dënimet plotësuese janë:Dënimet me të holla, Privimi nga e drejta të jete i zgjedhur, Ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimet publike , Ndalimi i ushtrimit të profesionit,aktivitetit apo detyrave të caktuara,Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik , Marrja e patentshoferit ,Marrja e sendit, Urdhëresa për publikimin e aktgjykimit , dhe deportimi i të huajve nga territori i Kosovës.

---

<sup>70</sup>Salihu, Ismet and Zhitija, Hilmi and Hasani, Fejzullah (2014) *Komentari Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. GIZ,

<sup>71</sup> E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prof, Ismet Zejneli , shkup, 2005

<sup>72</sup> Kodi penal i republikës së maqedonis, prof, Afrim Osmani, 2010, shkup

Ne keto denime vetem denimet kryesore dhe alternative parashihen qe te bejne pjese ne shqiptimin per veprat penale kunder pasurise ose ndryshe te vjedhjes, qe eshte denimi me burgim dhe denimi me gjobe dhe ajo me kusht. Dhe denimet plotesuese ndodhe qe te bashkangjiten se bashku me denimet e lartpermendura por ne raste te veqanta kur gjykata e parasheh qe duhet te ju shqiptohet edhe ky denime.

### 3.2.Dënime me burgim për veprat penale te vjedhjes

Denimi me burgim mundë te shqiptohet si denim kryesore dhe kete vetem atehere kur është i percaktuar me ligj, per llojin e caktuar te veprave dhe nuk mundë te jete me i shkruter se 15 dite por edhe me i gjate se 20 vjete [ neni 38 i LP te Kosoves], ne Kodin penal per veprat penale kunder pasuris ato munden te parashihet vetem deri 10 vjet ose 12 vjet per kryerjen e vepres penale te vjedhjes.<sup>73</sup>

Denimet me burgim shqiptohen ne vite plote dhe muaj te plote dhe gjere me 6 muaj edhe ne dite te plota. Kur gjykata shqipton denimin me burgim gjer ne 3 muaj mundë te urdheroj qe ai denim te zevendesohet me denim ne te holla apo edhe ne pajtim me te denuarin edhe ne pune me dobi shoqerore.<sup>74</sup>

Sipas KPK denimi per veprat penale te vjedhjes fillon prej 6 muaj, 1 vit, 3 vite, 7 vite,10vite e deri ne 15 vite per vjedhjet qe ndahen ne kategori te ndryshme sipas Kodit Penal te Kosoves. Nga pasoja qe shkaktojne kryesit nga kjo veper penale .

Te gjitha lejislicionet penale e njohin denimin e privimt nga liria – burgimin.

Ky denim konsiston ne marrjen e lirise se levizjes dhe qarkullimit personit te gjykuar per nje kohe te caktuar . Ky denim është i vetmi i privimit nga liria me te cilin realizohet mbrojta shoqerise nga kriminaliteti dhe arrihet risocializimi i delikuentit.<sup>75</sup>

Nga ky kend veshtrim ky denim paraqitet si denimi themelore dhe me i rendesishmi ne sistemin e dënimeve . Ky lloj i denimit është i parapare per nje numer te madh te veprave penale si denimi i vetem, por ne alternacion me denimin ne te holla.

---

<sup>73</sup> Komentari i Kodit penal- Akademik, Kosove 2010;

<sup>74</sup> E drejta penale pjesa e posaqme, Prof. Elezi, Ismeti ,Tirane ,2005

<sup>75</sup>Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikes se Kosoves, nr.19/Korrik 20012, Prishtine

Denimi i privimit nga liria burgimi konsiston ne marrjen e lirise se levizjes dhe qarkullimit kryesit te vepres per kohen e caktuar te percaktuar me aktgjykim te gjykates. Ne te gjitha legjislacionet baskohohore ky denim ze vendin qendrore.

Numri me i madh i veprave penale është i perfshire me kete denim ngase ky denim ofron mundësi me te medha qe te realizohet qellimi i denimit i cili konsiston ne riedukimin dhe risocializimin e te gjykarit dhe kthimin e serisem te tij ne binaret normal jetesore. Denimi i privimit nga liria është inkorporuar ne te drejten penale me propozim te Bekaries.<sup>76</sup>

Kete lloje te denimit me heret e futi ligji penal francez i vitit 1791 nga i cili me vone e muar edhe codi penal i vitit 1810, ku me pas edhe kalon – perfshihet edhe ne legjislacionet tjera . Mbyllja e cila gjeri atehere zbatohet si mase kishte karakter te sigurimit te presences se kryesit te vepres ne menyre qe ne te te egzekutohet ndonje mase tjeter ndeshkuese si shkaktimi i lendimeve trupore apo edhe vrasja. Ne krahasim me dënimet trupore te cilat konsistonin ne mundëime, torture sakatim gje qe ka lene pasoja te thella ne invaliditetet, futja e denimit me burgim paraqet kthese te madhe dhe progres ne kete fushe.

---

<sup>76</sup> Prof.Dr.Ismet Salihu, E drejta Penale pjesa e pergjithshme, botimi I dyte, 2003, Prishtine

### 3.3. Dënimi me gjobë për veprat penale të vjedhjes

Denimi me gjobë bën pjesë në dënimet pasurore dhe ka gjenezë të hershme që nga koha e shëndrrimit të hakmarrjes personale në kompozicion formë e ndërmjetesimit të shtetit në zgjedhjen e rasteve, kompozicionin e favorizonte shumë shteti ngase nga një pjesë e mjeteve të paguara i takonte shtetit në emër të ndërmjetesuesit në mes të dëmtuarit dhe kryesit të veprës penale kurse pjesa tjetër personit të dëmtuar.<sup>77</sup>

Me kalimin e kohës këto dy pjesë të kompozicionit kanë fituar pavarësi, kështu që pjesa e parë u shndërroi në dënim me të holla (gjobë), i cili dënim ka karakter publiko-juridik.

Me vone lindi mekanizmi i konfiskimit të pasurisë si formë e dhunshme e marrjes së vlerave pronore dhe të drejtave. Edhe dënimi me gjobë, edhe konfiskimi i pasurisë bëjnë pjesë në dënime të cilat i hasim shumë herë gjatë historisë të së drejtës penale dhe të cilat janë zbatuar në masë të madhe deri në fund të shek. 19. Që nga revolucioni francez këto dënime humbin karakterin e tyre fiskal, kështu që edhe aplikimi i tyre ngushtohet gjithnjë.

Dënimet pasurore në teorinë e së drejtës i janë nënshtruar kritikës, posaqërisht dënimi me të holla. Kundra këtij lloji të dënimeve paraqiten arsyet në vijim:<sup>78</sup>

1. Dënimet pasurore nuk janë të natyrës personale, ngase me egzekutimin e tyre goditen edhe anetare të tjerë të familjes të cilët nuk janë fare fajtor për veprën penale të kryesit,

2. Dënimet pasurore janë të padrejta ngase rëndë i godasin të varferit e me pak kryesit imun të veprave penale. Ithtarët e dënimeve pasurore konstatojnë se ky argument nuk qëndron ngase përcaktimi i dënit me gjobë bëhet në harmoni me gjendjen pasurore të kryesit të veprës penale, ku para se gjithash mirret parasysh edhe numri i anetareve të cilët i ushqen kryesi i veprës gjegjësisht të cilët jetojnë nga pasuria e tij,

3. Egzekutimi i dënimeve pasurore posaqërisht të dënit me të holla mundë t'i iket p.sh ndërprerjen e marrdhënjes së punësapo edhe humbjen e burimit të të hyrave në anën tjetër ngarkimin me obligim, dhënjën e dhuratave. Duke e pranuar këtë mundësi ithtarët e dënimeve pasurore e paraqesin faktin se në rastin e tillë egziston mundësia që dënimet me të holla të jenë të zëvendësuar me dënimin e privimit nga liria,

---

<sup>77</sup> Prof. Dr. Ismet Salihu, E drejta Penale pjesa e përgjithshme, botimi I dyte, 2003, Prishtinë

<sup>78</sup> Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prof. Ismet Salihu, Prof. Hilmi Zhitija, Prof. Hasan Fejzullahu, botimi 2014, Prishtinë

4. Dënimet pasurore nuk ndikojnë ne riedukimin e kryesëve te veprave penale ngase nuk godasin shkaqet e veprimtarive kriminale.<sup>79</sup>

Si kunder argument paraqitet fakti se edhe dënimet tjera nuk godasin gjithëherë shkaqet e kriminalitetit. Edhe pse këtyre denimve mundë tu bëhen verejtje ato me gjithë ate konsiderohen si mjete adekuate në luften kunder kriminalitetit e posaqerisht kur bëhet fjalë per veprat penale te vjedhejs, veprat e kryera nga perfitimi dhe si alternativë dënimet e shkurta me burgim.

Denimi me të holla konsiston ne obligimin e personit te gjykuar që në afatin e caktuar është i obliguar të paguaj shumën e caktuar te shqiptuar si denim ne aktgjykim ne dobi te shtetit. Me shqiptimin e denimit me te holla ne mes te kryesit te vepres dhe shtetit krijohet raporti obligativ kur shteti paraqitet si kreditor e kryesi si debitor (borxhli).

Denimi me te holla ne veprat penale te vjedhjes, mundë te shqiptohet si denim kryesore por edhe si denim plotesues. Si denim kryesor mundë te shqiptohet atëhere kur ne ligjin penal është i percaktuar si alternativ me denimin me burgim. Si denim plotesues mundë te shqiptohet atehere kur ne ligjë është i pershkruar si denim komulativ me denimin me burgim, mirepo edhe atehere kur nuk është fare i pershkruar ne qoftëse vepra penale është kryer nga motive të perfitimit.

Denimi me te holla sipas nenit 39 te L.P. te Kosoves shqiptohet ne shumën e caktuar fikse .Denimi me te holla ne shumën fikse mundë te shqiptohet prej 50 euro – gjere ne 25 mije euro, dhe ne qoftese behet fjalë per veper penale nga motiv i perfitimit atehere maksimumi i pergjithshem është 500.000 euro qe vlen edhe per veprat penale te vjedhjes.

Te shqiptimi i denimit me te holla gjykata është e obliguar qe ne aktgjykim te precizoj edhe kohen e pageses se denimit. Ai afat nuk guxon te jete me i shkurter se 15 dite e as me i gjatë se 3 muaj. Afati llogaritet nga dita e plotefuqishmerise se aktgjykimit. Ne raste te arsyshme gjykata mundë te lejon pagesen e denimit edhe ne kiste [ rata ] mirepo atehere gjykata është e obliguar te specifikoj numrin e kisteve , kohen , shumën e caktuar per kiste si dhe kohen e pergjithshme e 118 cila nuk guxon te kaloj mbi 2 vite.

Per veprat penale te vejdhjes sipas KPK ajo fillon prej kesaj shume e pesëdhjetë (50) Euro, dhe jo me pak se e pesëdhjetë (50) Euro. Ky denim n' varet nga shkaktimi I

---

<sup>79</sup> <sup>79</sup>Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikes se Kosoves, nr.19/Korrik 20012, Prishtine

pasojes qe e ka shkaktuar vepra penale e vjedhjes qe siqepemdem me larte mundet te shkoje edhe deri ne maksimumi i pergjithshem është 500.000 euro.

Dënimet e shqiptuara dhe te egzekutuara paraqesin te hyrat e caktuara te bugjetit. Ne qoftese denimi me te holla nuk mundëet ne teresi apo pracialisht te paguhet ne afatin e paraparë me vendim te gjykates, atehere gjykata pa prollongim nxjerr vendim te ri mbi zevendesimin e denimit te mehereshëm me denim te ri me burgim ashtu qe qdo 15 euro te denimit te paraparë ne te holla te zëvendesohet me një ditë te kaluar ne burg, por qe ky denim i zëvendesuar ne këtë perpjetesim nuk guxon te zgjasë më shum se 6 muaj [ neni 39 pika 4 IL.P. te Kosoves] .

Per aq sa personi i denuar e paguan vetem nje pjese te denimit mbetja shëndrrohet ne burgim ; 15 euro = 1 dite burg , ne qoftese i denuari e paguan edhe pjesen tjeter atehere egzekutimi i denimit me burgim nderpritet. Ky lloj i burgimit ne teori quhet burgim supletar – per te cilen nuk vlejne shumica e dispozitave mbi denimin me burgim [ mbi lirimimin me kusht , mbi minimumin e pergjithshem etj] . Me vdekjen e personit te denuar te cilit i është shqiptuar denimi me te holla, atëherë shuhet edhe vet denimi ne menyre që te ruhet karakteri personal i tij.

#### 3.4. Zëvendësimi i dënimeve me dënime tjera për veprat penale te vjedhjes

Per veprat penale te vjedhjes parashihet denimet kryesore si denimi me burgim dhe denimi me gjobe, gjithashtu hyjne edhe denimet alternative e cila eshte denimi me kusht.

80

Por duhet ti permendimi edhe denimet plotesuese se bashku me denimin kryesor dhe denimet alternative qe shqiptohen per veprat penale te vjedhjes si, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës, konfiskimi, dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës. Te gjitha ne varen nga veprat penale qe kryesi i shkaktohen por me prezenta eshte sit e kryesit e rritur dhe atyre te mitur denimi me burgim ne gjobe ose ne dobi te pergjithshme.<sup>81</sup>

<sup>80</sup> <sup>80</sup>Gazeta Zyrtare , Kodi Penal I Republikes se Kosoves, nr.19/Korrik 20012, Prishtine

<sup>81</sup> Prof.Dr.Ismet Salihu, E drejta Penale pjesa e pergjithshme, botimi I dyte, 2003, Prishtine

Zëvendësimi i dënimit për veprat penale mundet të zëvendësohet në mënyrë të caktuar ku ajo parashihet sipas Kodit Penal të RK me kushte, gjobe dhe burgim deri 10 vite. Nëse kalon 10 vite atëherë nuk mundet të zëvendësohet që ja vlen edhe për veprat penale të vjedhjes që dënimin me burgim mundet të arrijnë deri në 17 vjet.

Por në raste specifike ajo mundet të zëvendësohet me dënimet plotësuese si kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimin me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar.

Sipas qëllimit dhe frymës së kësaj dispozite, në rastet kur gjykata e cakton dënimin me burgim deri në gjashtë muaj, nëse është e mendimit se qëllimi i dënimit me burgim mund të arrihet edhe me dënimin me gjobë, me pëlqimin e të dënuarit dënimin me burgim mund t'i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Mirëpo me rastin e interpretimit dhe zbatimit të kësaj dispozite, në shumë raste gjykatat e Kosovës nuk vepruan kështu por ua shqiptuan dënimin me burgim. Mirëpo pas një kohe, madje edhe pas një viti, edhe kur aktgjykimi ishte bërë i plotfuqishëm, me angazhimin e avokatëve dhe të dënuarve, gjykatat e Kosovës ua kanë mundur zëvendësimin e dënimit me burgim me dënimin e gjobë.

Duke e parë këtë praktikë të gabuar të gjykatave, Gjykata Supreme e Kosovës mori qëndrim që dënimin e caktuar me burgim, mund të zëvendësohet me gjobë në të njëjtën seancë, posa të shpallet vendimi, e jo pas një kohe, përkatësisht pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, që kjo vlen në dënimet për veprat penale të vjedhjes, që sipas nenit 48 Zëvendësimi i dënimit me burgim me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, që vepron në këtë mënyrë sipas KPK:

Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Nëse e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katërdhjetë (240) orë pune.

Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Gjithashtu për veprat penale të vjedhës mundet të zëvendësohet denimi prej burgimit në denimet alternative që hyjnë, denimi në nenin 57 të KPK si, Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues që vepron në këtë mënyrë :<sup>82</sup>

Gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konsideron se faktori kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale.<sup>83</sup> Gjykata cakton periudhën gjatë së cilës programi për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe të përfundojë. Periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se tre (3) muaj apo më tepër se dymbëdhjetë (12) muaj. Programi i trajtimit rehabilitues mbikëqyret nga shërbimi sprovues. Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajtimit rehabilitues siç kërkohet nga shërbimi sprovues. Nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimin të caktuar në dënimin me kusht.

Gjithashtu edhe në KPK në nenin 58 theksohet se denimi me burgim ose me kusht të veprës penale të vjedhës ajo mundet të zëvendësohet edhe në këtë mënyrë, si dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. Gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara nga gjykata arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues. Kur shqipton dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar që të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues. Gjykata, po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e parapara me paragrafin 3 të nenit 51 ose nenit 59 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e një kushti të shqiptuar nuk mund të jetë më pak se gjashtë (6) muaj e as

---

<sup>82</sup> Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prof. Ismet Salihu, Prof. Hilmi Zhitija, Prof. Hasan Fejzullahu, botimi 2014, Prishtinë;

<sup>83</sup> Kodi Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2012, Prishtinë



më shumë se tre (3) vjet. Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të parapara me nenin 59 të këtij Kodi, gjykata në veçanti merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore; mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën; motivet për kryerjen e veprës penale; sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale; sjelljen e tij të kaluar; rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen; dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së mbikëqyrjes. Nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 59 të këtij Kodi siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen mbikëqyrjes në kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

Ne kete kategori e kemi edhe Gjysemliria qe ndodhe shume shpesh te kryesit e vepres penale te vjedhjes nga denimi me kushte ne zevendesimin me gjysemliri. Ajo shqiptohet ne dënimin me burgim deri në një (1) vit, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo nevojën për trajtim mjekësor ose rehabilitues.

Gjatë vuajtjes së dënimit në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata. Kur personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1. i këtij neni, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg. Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e përcaktuara me nenet paragrafin 3. të nenit 51 ose nenin 59 të këtij Kodi. Theksojme edhe denimet plotesuese qe ndodhe qe gjykate i zevendeson denimet e vepres penale te vjedhjes me denimet plotesuese e ajo ndodhe ne keto pika.

Zevendesimi I dënimit me burgim, gjobe dhe kusht e lartepremdem deri me tani se si zevendesohet per veprat penale te vjedhjes, por duhet te permendemi edhe denimet plotesuese qe zevendesohet denimi per veprat penale te vjedhjes qe I kemi cekur meposhte. Ne nenin 64 te KPK kemi, Urdhrin për kompensimin e humbjes apo dëmit ajo vepron

Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo veprë penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale. Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimat i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë veprë.

Edhe në nenin 65 të KPK kemi këtë zëvendësim si, Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Gjykata ia ndalon kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në pesë (5) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht. Neni 66 Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit të veprës penale ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarisë së pavarur, detyrës menaxhuese apo administrative ose detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdorur pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritë që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale. Gjykata e cakton kohëzgjatjen e dënimit të caktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) vit e as më i gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që ky dënim me kusht të revokohet nëse kryesi nuk e respekton ndalesën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Në nenin e 69 të KPK theksojmë marrjen e sendit, që ajo vepron në sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes

së veprës penale do të konfiskohen. Sendet nga paragrafi 1. i këtij neni mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryesit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme ose për arsye të moralit, nëse kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë nga kryesi kompensimin e çfarëdo dëmi. Me ligj mund të përcaktohet marrja e detyrueshme e sendit.

Te KPK ne nenin<sup>71</sup> është zëvendësimi I fundit për denimet e veprës penale të vjedhjes është Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës: Gjykata mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Kur gjykata vendos për shqiptimin e dënimit nga paragrafi 1. i këtij neni dhe kohëzgjatjen e këtij dënimi, gjykata merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës. Dënimi nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shqiptohet nëse ekzekutimi i dënimit është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Kohëzgjatja e dëbimit llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

### 3.5. Qellimi i dënimit ndaj të denuarëve për veprat penale të vjedhjes

Qellimi i dënimit sipas së drejteve penale dhe dispozicioneve penale, duke interpretuar dispozitat e caktuara të ligjit penal të Kosovës rezulton se qellimi i dënimit është : Që të shprehet gjykimi shoqëror për veprën e kryer penale, që të ndikohet në kryesin që në të ardhmen të mos bëjë vepra të tilla, që të ndikohet në qytetarët tjerë që të mos kryejnë vepra penale, që të ndikohet në vetëdijen e qytetarëve mbi anën e dëmshme të veprave penale si dhe mbi dënimin e drejtë të kry<sup>84</sup>esit.

Kjo do të thotë që ligjdhënësi nisët nga kuptimi se qellimi final i dënimit është mbrojtja e shoqërisë gjegjësisht të mirave dhe vlerave tjera shoqërore nga kriminaliteti dhe qellimi i tij drejtpërdrejtë është i përcaktuar si i dyfishtë:

---

<sup>84</sup> Prof. Dr. Ismet Salihu, “ E Drejta Penale “- Pjesa e përgjithshme , Prishtinë, 2014;

a)Prevecioni special ( i veqantë) në frymen e parandalimit të kryesit në kryerjen e vepres penale dhe në përmirësimin e tij, edukimin<sup>85</sup>

b)Prevecioni i përgjithshëm ( gjeneral) në frymen e ndikimit edukativ në qytetarët tjerë që të mos kryejnë vepra penale dhe ndikimin në vetëdijen e tyre mbi anën e dëmshme të veprave penale domosdoshmërinë e denimit të kryesit të tyre gjegjësisht përmes zhvillimit dhe përforrçimit të përgjegjësisë shoqërore në kuptimin e gjykimit të veprave të kryera dhe gjykimit të kryerësve të tyre gjegjësisht vetëdija mbi nevojën e respektimit të ligjit dhe normes së rendit juridik në përgjithësi. Edhe ligjet tjera penale bashkëkohore ngjashem përcaktojnë qëllimin e denimit.

Ne drejten penale edhe ne Kodin Penal te Republikës se Kosoves ne nenin 41 qellimi I denimit per kryesit e vepres penale te vjedhjes, edhe atyreve veprave penale te tjera jane keto qe do I cekemi:<sup>86</sup>

1. të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;
2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;
3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe
4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 3.6 Kohëzgjatja e denimeve për veprat penale te vjedhje

Kohezgjatja e denimeve per veprat penale te vjedhjes, percaktohet me dispozitat e akteve ligjore si te Kodit Penal te RK, dhe te Kodit te Procedures Penale. Por n'varet edhe prej llojit te vepres penale, menyres, lartesis se denimit, pasojes qe e ka shkaktuara ajo veper, motivet, mjetet e perdorimit, vendin e kryerjes, dhe klasifikim e saj si veper sipas dispozitave ligjore te parapara per te.<sup>87</sup>

---

<sup>85</sup> Vllado Kambovski&Ismail Zejneli, Drejta Penale - Pjesa e pergjithshme –Tetove, 2018;

<sup>86</sup> Gazeta Zyrtare, Kodi nr. 04/I-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012, Prishtine;

<sup>87</sup> Gazeta Zyrtare, Kodi nr. 04/I-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012, Prishtine;

Kur caktohet dënimin për vepër penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale.

Gjykata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin

Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme:<sup>88</sup>

Shkallën e përgjegjësisë penale;

Motivet për kryerjen e veprës;

Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur;

Rrethanat në të cilat është kryer vepra;

Sjelljen e mëparshme të kryesit;

Pranimin e fajit dhe

Rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur.

Me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit.<sup>89</sup>

---

<sup>88</sup> Prof.Dr.Ismet Salihu, E drejta Penale pjesa e pergjithshme, botimi I dyte, 2003, Prishtine

<sup>89</sup> • Murati, Rexhep, Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë, 2006.

Sipas kodit penale ne nenin 325, kohezgjatja e denimit per persona qe denohet per kete veper penale me gjobe arrine shumen prej 50 euro apo ma shume, dhe me burgim deri tre (3 )vjet, ose mund te denohet me gjobe me pak se (50 )euro dhe me burgim deri (6) muaj.

Varesisht nga vepra penale denimi me gjobe mund te tejkaloje deri 5.000 euro deri ne 10.000euro ose ne Shumen me te madhe qe arrine ne 25.000euro, dhe denimi me burgim mund te tejkaloje prej shtate (7)vjet, dhjete(10)vjet,dymbedhjete(12)vjet,pesmbedhjet(15)vjet.

### **Kapitulli i III- te**

#### **Veprat penale te vjedhjes në territorin e Gjykates Themelore Gjilan-dega Viti per periudhen 2015-2018**

##### **1.0 Vellimi dhe dinamika e veprave penale ne territorin e Gjykates Themelore Gjilan-dega Viti per periudhen 2015 dhe 2018.**


Vellimi ne kete gjykate eshte shume I madhe per shkak te veprave te shumta te vjedhjes qe dominon ne kete komune si dhe ne gjdo komune tjeter, veprat penale te vjedhjes siq njihen ne Kod Penl te Republikes se Koves ne Kapitullin XIV Veprat penale kunder pasurise jane vepra qe ndeshmi gjdo dite me to , mandej ne perpunimin stastikore te ceshtjeve penale te procedures nder vite ky grup krimes perfaqeson e figurave te veprav penale me te medhaja te provedura dhe prirje numerike ne rritje.

Keshtu sipas Vjetorit Stastikore te Gjykates Themelore Gjilan- dega Viti ne periudhen kohore te viteve 2015 deri 2018 jane proceduara 557.97, Vepra kunder pasurise nga nenet e Kodit Penal te Republikes se Kosoves ( 325, 326,337,329,332,335,), dhe gjithashtu dhe vepra tjera te cilat nuk jane ne kuader te veprave penale te pasurise por aty jane te pranishme shume si vjedhje si vepra penale te ekonomise ne nenin (3589 si dhe vepra penale si vjedhje pylli.


Po te krahasohen me vellimin e qeshtjeve te procedures nga Gjykata Themelore Gjilan-dega ne Viti ne vite , e shohemi se veprat penale kunder pasuris si vjedhja ato hyjne aty si: mashtrimi, vjedhje e rende, uzurprimi i prones, fajde etjr. Ato jane duke u paksuar ne numer ndjeshem , dhe e perbejne te vetmin grup krimesh qe ka pesuar renie.

Me poshte do i cekemi perqindjen e tyre gjate viteve te rasteve dhe pjesemarrjen e veprave penale sipas Kodit Penal te RK, ne territorin e Gjykates Themelore Gjilan-dega ne Viti gjate periudhes 2015-2018.

**Perqindja e rasteve ne territorin e Gjykates  
Themelore Gjilan-dega ne Viti gjate periudhes 2015-  
2018 per veprat penale te vjedhjes**



**Veprat penale sipas Kodit Penal te Republikes se Kosoves  
ne territorin e Gjykates Themelore Gjila-dega Viti gjate  
periudhes 2015-2018**






## 1.1 Dënimet e shqiptuara të vjedhjes nga gjykata themelore Gjilan- dega Viti për vitin 2015-2016

Denimet e shqiptuar ne peridhuen 2015-2016 jane shumica te perfunduar ne menyre sa me te mira sipas te dhenave ne raporte vjetore te kesaj gjykate rreth kesaj vepre penale. Ne kete periudhe ne vitin 2015 jane rregjistruar 1,970 raste te ndryshme ne kuader veprave penale te pasurise , ku 891 raste te perfunduar me suksese, 155me shqiptim denimi me gjobe,460 me kushte, 35 me veqim, 13 me hudhje aktakuzes, 8 me burgim ne raste ndryshem prej 90 dite ne 10 vjet siq parashihet me kod penale te kosoves dhe 400 raste te pa perfunduar akoma.


Sipas te dhenave hasmi ne vepra penale si veprat penale te vjedhjes se rende, vjedhja, mashtrimi, vjedhje e sherbimeve, marrja ne posedim pasurise se luajtshme, uzurprim I paligjshem I prones, dhe gjithashtu me e pranishme si ne qeshtje penale dhe me ligje te ri eshte parapare dhe ne lemin e kundervajtjes qe eshte vjedhje pylli e cila eshte me nr, me te madhe nga gjithë vjedhjet.



## 1.2 Dënimet e shqiptuara te vjedhjes nga Gjykata Themelore Gjilan- dega ne Viti për vitin 2016-2017


Denimet e shqiptuar rrethe peridhues 2016 shihet se eshte nje renie pak ma e madhe se e vitit 2015 ketu kemi te bejme me kete numer te veprav penale te vjedhjes te regjistruar 150 vjedhje gjate kesaj kohe, te perfunduar I kemi 38 vjedhje, 17 me gjobe, 22 me kushte dhe 3me burgim dhe 2 me hudhje aktakuzes, 1 me veqim dhe 67 raste te pa perfunduara

Sipas kesaj periudhe vjedhjet me te pranishme kane qene ajo e vjedhjes se rende, te uzurpimit te prones dhe vjedhjet e sherbimeve komunale por ne mos munges se vjedhjes se pyllit .




### 1.3 Dënimet e shqiptuara te vjedhjes nga Gjykata Themelore Gjilan- dega ne Viti për vitin 2016-2017

Gjithashtu dhe ne kete vite kemi te bejme me nje rritje te veprave penale jo si ne vitin 2016 ne renie ne kete vit kemi nje numer te rregjistruar 253 vepra penale ku 101te rasteve jane te perfunduar , 42 me gjobe, 38 me kushte, 2 me burgim, dhe 70raste te pa perfunduara ne kete periudhe kohore.



#### 1.4 Dënimet e shqiptuara te vjedhjes nga Gjykata Themelore Gjilan- dega ne Viti për vitin 2018

Ne kete periudhe kohore shumica e rasteve jane te pa perfunduara te cilat vazhdojne ende duke u shqyrtuara te cilat pakica jane te perfunduar ngase nga viti ne vit keto vepra po ka renie dhe po behet cmos ka ana gjykates qe te jene te perfunduar me sukses, sipas raportit vjetor qe e kam nxjerru te dhena kemi te bejme me kete numer te veprave penale 153 raste ku shumica jane te pa perfunduara te cilat ende po vazhdojne ne shqyrtime gjyqesore. Ne kete numer kemi vetem 22 raste te perfunduara ku 11 me kushte te bashkangjitur me gjobe. Keto tjerat raste priten qe te perfundoje ne kohe te caktuar ne menyre sa me te rregullt.



## **2. Karakteristika personale te dënuareve me dënime për veprat penale te vjedhjes në territorin e Gjykates Themelore Gjilan -dega Viti**

### 2.0. Moshë e të dënuareve

Moshë gjithashtu është karakteristike e rëndësishme e veprave penale të vjedhjes, të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore penale, si dhe nga shenimet e kërkimeve, flasin për veprimet dhe sjelljet kriminale që merren personat e moshave të ndryshme. Në këtë drejtim vërehen disa ligjshmëri dhe kategori të moshave të cilat marrin me tëper pjesë në kryerjen e sjelleve të kriminale të veprave penale të vjedhjes. Siq dihet moshë e kryesore të veprave penale, përkatesishte sjelleve kriminale, mundet të ndahen sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas ligjeve pozitive penale të vendeve të ndryshme, gjithashtu dhe tek në moshë e kryesore të veprave penale, ndahet moshë atë personave në moshave të personave të mitur dhe personave të rritur.


Brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarje të tjera, moshë e mitur ndahet të mitur të rinj, e cila përfshin moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshinë moshën 16-18 vjet. Kategoria e personave deri në moshën 14 vjeçar në literaturë juridiko-penale dhe kriminologjike si moshë e fëmijëve që zakonisht personat e kësaj moshë nuk i nënshtrohen trajtimeve juridiko penale. Këta persona siq dihet nuk janë të përgjegjshëm ndërmirën masë të kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ana e familjes dhe organeve të drejtësisë të cilat merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe me kujdes social. Në disa shtete në këtë drejtim behen edhe përjashtime, shpeshëhere në disa shtete të Lindjes, moshë e personave prej 10-14 i nënshtrohet përgjegjësisë së caktuar penale.

Si moshë e rritur konsiderohet moshë prej 18 e deri në vdekje të individit, pjesëmarrja në këto vepra penale në këtë moshë nuk është njësoj në të gjitha fazat e jetës së këtyre individëve. Në literaturën juridiko penale dhe kërkime në praktike sipas të dhënave, kemi ndarje dhe kategorizim i moshave të personave të rritur zakonisht behet me decade psh, faza 10 apo 20 vjetësh apo edhe më pak. Flitet për moshën e personave të rritur prej 18-25 vjet si moshë e vecante, pastaj prej 25-30, moshë 30-40 vjet, moshë 40-50, moshë 50-60 dhe në fund moshë më vjetër se 60 vjet. Në të dhënat statistikore, gjyqësore vërehet se moshat më prezente në veprimet kriminale janë moshat prej 25-30 pastaj grupi i moshës 30-50 dhe më pak i moshës mbi 60 vjet. Duhet theksohet se edhe moshë prej 18-25 është present edhe kjo vlerohet si një i ashtuqujtur kriminaliteti i të rinjëve i cili në botën bashkëhere tregon karakteristika të vecanta, si për nga mënyra e kryerjes ashtu edhe për kah intensiteti i paraqitjes në veprimet kriminale.

Mosha e re merr pjese me shume ne kryerjen e krimeve kunder pasurise si jane vjedhjet me thyerje, grabitje, mashtrim, vjedhje te rende etj. Ndersa edhe te rriturit gjithashtu duke filluar nga krimet kunder pasuris deri te veprat tjera.

Grupi I moshave 25-30 dhe 30-50, eshte grupi I popullates me active ne jeten e perditshme ne cdo shoqeri. Keto grupe te moshave me se shpeshti ballafaqohen me problemet te llojllojshme te jetes se perditshme. Per kete arsye edhe ata vijne ne situate qe me se shpeshti kryerjen sjelljen kriminale dhe te shkaktojne vepra penale te caktuara te cilat sjellin humbje ne shoqeri.

**Të dhëna statistikore dinamike mbi të miturit dhe personat madhor ne raporte vjetor per veprat penale ne territorin e Gjykates Themelore Gjilan–dega Viti gjate periudhes 2015-2018:**



**2.1 Gjinia e dënuareve**

Ne pjesemarrjen e veprave penale , ajo veshtrohet ne lemin penalo-juridike dhe kriminologjike dhe interpretohet nga kunderveshtrime te ndryshme. Kemi te bejme me nje pershtypje te pergjithshme ne baze te dhenave te statistikore dhe praktikes gjyqesore se veprat penale te vjedhjes dhe gjithashtu dhe tjerat jane nje dukuri tipike mashkullore. Sipas kerkimeve te praktikes gjyqesore ne shume vende te botes si ne SHBA, Gjermani,France,Angli,Japoni dhe vende tjera, qe ketu hyjne dhe Shqiperia, Kosova, e Maqedoni kemi te bjeme me kryersite gjinise mashkullore po dominojne ne menyre

absolute. Por ne shoqerine bashkohore gjendja ka ndryshuar dukshme ngase dhe gjinia femerore gjithnje e me teper po marrin pjese ne kryrjen e veprave penale te llojllojshme kriminale poashtu dhe te vjedhjes.


Sipas te dhenave statistikore 2015-2018, te gjykatave komunale te kosoves, qe ben pjese edhe gjykata themelore gjilan-dega vitii, mbi kryersit e veprave penale te vjedhjes sipas gjinis dhe llojit te disa veprave penale del se 95% te ketyre veprave kryejne personat e gjinis mashkullore e vetem 5% te gjinise femerore.

Sipas te dhenave stastikore ne Gjykata komunale te Kosoves, po verehet se femrat marrin pjese ne kryerjen e krimeve kunder pasurise, gjithashtu dhe veprat penale kunder jetes dhe trupit, kunder prones, e sidmose te aktivitetve qe kane te bejne me prostitucione etj.

Si karakterstike eshte se femra po merr pjese ne kryrjen e ketyre veprave penale si ndihmese, shtytese, e me pak si e drejtperdrejte apo ne grupe kriminale te caktuara.

Duhet te theksojme se femrat jane te kyqura ne keto vepra penale nen ndikimin e rrethanave te caktuara, shoqerore, ekonomike te cilat pak a shume jane indentike edhe per gjinine mashkullore. Femra merr pjese me pak ne kryrejen e sjelleve te ndryshme kriminale nga se ajo ne te kaluaren ka qene me pak e perfshire ne aktivitet ndryshme shoqerore, pjesemarrja e vogel e femres mundet te kerkohet ne poziten e saj shoqeror, familjare, ekonomike, politike te cilen e ka pasur ose e ka sot ne shoqeri. Femrat deri ne shoqerine bashkohore nuk kan qene te kyqur ne proceset e pergjithshme te jetes , ato me teper kane qen te prekopuara ne lindjen, rritjen, kujdesjen ndaj femijeve dhe antareve te familjes e me pak jane marr me akivitet dhe pune jasht familjes te cilat sot domisdo do ti futnin ne suate te palakmueshme qe do sjellnin deri te kryreja e veprimev penale.

Me emancipimin dhe kycjen me te madhe te femres ne githa sferat e jetes dhe te punes po vrehet edhe shtimi dhe rritja e pjesemarrjes se saj ne aktivitet penalo-juridike.



## 2.2 Përkatesia kombëtare

Ne Republikën e Kosovës me perkatesi kombetare nenkuptojme shoqeri shumetnike, njekohesishte qe kjo shoqeri shumetnike perbehet nga shqiptaret dhe komunitete e tjera. Ajo vepron ne menyre demokratike , mbi bazen e parimit te sundimit te ligjit.

Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve. Republika e Kosovës ndërmerr masat e veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta. Këto masa nuk konsiderohen si akt diskriminimi.

Personat që iu përkasin komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtë t'i gëzojnë individualisht apo së bashku me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut 2 që janë përcaktuar në obligimet ligjore ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Kosovës. Këto të drejta dhe liri garantohen me kushtetutë, me ligje, rregullore dhe politika tjera shtetërore.

Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj. Çdo person që i takon një komuniteti ka të drejtë që lirisht të zgjedhë të trajtohet apo të mos trajtohet si i tillë dhe asnjë dëm apo diskriminim nuk do të rezultojë nga zgjedhja e ushtrimit apo jo të të drejtave të cilat lidhen me këtë zgjedhje.

Gjatë ushtrimit të lirë nga ana e tyre të të drejtave dhe lirive të mbrojtura me këtë ligj, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre i respektojnë të drejtat e të tjerëve. Autoritetet në Republikën e Kosovës, përfshirë gjykatat, e interpretojnë këtë ligj në pajtim me garancitë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, në obligimet e aplikueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë dispozitat e Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare



### 2.3 Statusi social

Ne shenimet e me hereshme te praktikes gjyqesore ka dominuar mendimi se kryrejen e veprimeve kriminale fillone qe nga shtresat e uleta, e sidmose per kategorine e punetoreve dhe njerezve te papune dhe te varfer. Keto konstatime jane bazuar ne shenime mbi numrim e personave ndaj te cileve jane bere kallzime penale, ngritje te aktakuzes,ose shqiptime te denimeve nga ana e gjykataave. Ne vende te botes kemi me shume rritje te veprave penale ,nga ana e pjesemarrjeve e punetoreve dhe profesioneve tjera te shtresave te uleta dhe te mesme te popullsise, qe si kategori merr pjese ne kryrejen e veprave penale kunder pasurise por dhe kunder jetes dhe trupit, kunder ekonomis etj.

Por ne dekada te fundit rritje te vazhdueshme tregone edhe veprimet qe kryhen nga ana e personave te shtresave dhe klasave te larta, qarqave afariste dhe atyre ne pushtet.<sup>90</sup> Keshtu kemi te bejme me ashtuqujturen kriminaliteti i “jakes se bardhe” qe eshte vazhdimishte ne rritje.

Per pranine e ketyre veprave penale mirret vesh here pas here, vetem kur shperthejne aferat dhe konflikte Brenda qarqave te larta ne pushtet, mirpo edhe segmentet e caktuaraa te pushtetit bejne perpepjekje qe keto veprime ne shumten e rasteve te mbyllen pa epiloge gjyqesore.

Po te flasmi per vendin tone ateher Kohen e fundit eshte me prezente se kurr, kjo po ndodhe nga personat me pushtet te fuqishem qe po perdorin forcat e tyre qe te nderhyrjen ne komptencat gjyqesore qe jane te garantuara me dispozita ligjore dhe akte te ndryshme.

### 2.5 Statusi martesor

Rendesi te posacem ka edhe trajtimi I statusit martesor ose familjare, perkatesishte gjendja martesore e tyre. Ne baze te dhenave te evnidencave statistkore te gjykatave komunale gjithashtu dhe asaj gjykates themelore gjilan- dega ne viti , po vrehet se numri I madh I kryreseve te ketyre veprave penale dhe te tjerave , jane te martuar,ne rend te dyte vijne personat e pamartuar, personat e ndare dhe te shkurorezuar dhe ne fund personat e ve.

---

Kriminologjia , prof, Ragib Halili, botimi shtate, Prishtine, 2011  
Politika Kriminale,prof, Vesel Latifi, Prishtine, 2008

Pjesemarrja e femrave te martuara , te ndara, dhe te veja , eshte e shprehur ne kryrjen e veprave penale te ndryshme e sa te meshkujt e se njejtjes gjendje martesore. Kategoria e personave te pamartuar, paraqitet me teper te gjinia mashkullore.

#### 2.4 Niveli arimor i dënuarëve

Arsimimi eshte nje nder forcat me te madhe ndikuese ne aspektin e edukimit , te ngritjes kulturore e edhe ne aspektin e zhvillimit emocional dhe intelektual dhe ne formimin ne tersi te personalitetit te njeriut.

Kjo per arsye se ajo ka kontakte me pjesen me te madhe te rinise qe nga rinia e hershme e deri ne moshen e pjekurise. Pasi qe arsimimi paraqet prej femijerise ne ndonje shenje te vecanta dhe mund te parashikojne trajtimin individual te atyre qe i shfaqin shenjat e papershtatshmerise se sjelljetveta.

Per kete arsye arsimimi eshte ne gjendje ti korrigoje devijimet psikike e te tjera te rinjve dhe ti orientoje drejt.

Andaj arsimimi duhet te kryhente procese te ndryshme edukative ne menyre qe ti eliminoje dukurit negative ne sjelljet e rinise, mosinteresimin, vjedhje te imta, ikjen nga shkolla etj.

Hulumtimet e ndryshme tregojne delikuentet e mitur ne numrin me te madh e lene arsimimin dhe nuk merren me pune te dobishme dhe kryejne vepra kriminale.

Keta te mitur te ikur nga shkolla jetojne me se shpeshti ne ambiente me nivel te zhvilluar ekonomiko- kulturor , me trafik te zhvilluar se sa ata te mitur qe jetojne ne ambiente te pazhvilluara ekonomiste si ne fshatra apo qyteza.

Mos arsimimi paraqet tek personat kriminale qendrimet e keq te shoqerise, familjes se parregullt dhe sjelljeve delikuent. Rruga e tille nuk shpie ne riedukim.

Per shkak te qasjes individuale dhe qe te evitohen pasoja e mosuksesit ne arsim shume vende jane zhvilluar shkolle speciale per nxenesit me pengesa qe punojne ne baze te programit i cili ju pergjigjet atyre. Keshtu jane hapur shkolla per persona te shurdher, subnormal, pastaj per permiresimin e nxenesve etj.

Personat e denuar pa te arsimuar ne RK-se, sipas Ligjit per ekezkutimin e sanksioneve senal, nuk ju garanton arsimim te larte te burgosurve qe vuajne denimin naper qendra korrektuese dhe burgje.

Statistikat e Shërbimit Korrektues në Kosovë tregojnë se në shkollimin e lartë aktualisht nuk i vijon studimet asnjë i burgosur. Kjo pasi që ky shërbim nuk ka bazë ligjore t'ua lejojë një gjë të tillë.

## Kapitulli i IV-te

### Parandalimi dhe luftimi i veprave penale të vjedhjes kur shqiptohen sanksionet penale

#### 1.Masat preventive

##### 1.0. Arsimimi dhe edukimi

Arsimi eshte nje faktor me rendesi ne formimin dhe aftesimin e personaliteti te njerit per jete me te sigurt dhe me te suksesheme. <sup>91</sup>Nje kohe te gjate eshte menduar se arsimimi eshte nje mjet i fuqishem per pengimin e sjelleve devijante dhe kriminale. Qysh ne kohën e me hershme eshte theksuar se me ane te arsimimit te njerzeve luftohen shume te kqia shoqerore ,ku njeriu i arismuar eshte me i afte per te dalluar te keqen nga e mira, ku personat e arsimuar me veshtersi mund te bien ne ndikime negative. Ata jane te pasur me dije dhe informata te shumta dhe e kane me lehet te marrin qendrime dhe sjellje pozitive.<sup>92</sup>



Ku personat e arsimuar jane te pegaditur qe te jen te afte tu kundervihen provokimeve dhe nxitjeve te ndryshme te jetes se perditshme por ne ditet e sotme mundet lirishte te themi se po ndodhe e kunderta ne disa raste ku kemi te bejme me kryersit e cilit edhe jane te arsimuar por gzojne nje populloritete tek vendi i tyre.

Ne anen tjetere personat e paarsimuar me veshteresi kyqen ne shumten e proceseve jetesore , atyre u mungon aftesia per ta kuptuar dhe per te gjykuar drejt pasojat e veprimeve te ndryshme, me cka ata nuk jane te afte tu bejne rezistence nxitjeve dhe sporvae te ndryshme ne ambiente shoqerore.

Sipas disa autoreve theksojne se ne mes sjelleve kriminale te individeve dhe shkalles se arsimimit egziston nje lidhje e drejtperdrejte, ku personat e paarsimuar te cilet kryejne krime jane te zhveshur nga ndergjegjija dhe etika ata u nenshtrohen lehet instinkteve dhe impulseve emocionale. Te ata shpesh dominon ndjenja e epsheve momentale per te

<sup>91</sup>Prof.Dr. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011

<sup>92</sup> Vesel Latifi, " Politika Kriminale" , Prishtinë, 2003;

ardhur deri te ndonje qellim apo per ta realizuar ndonje interes,si ndikim i motive biologjike.

Nga ana tjeter eshte e perhapur edhe mendimi i cili thekson se arsimimi nuk ka ndonje ndikim te vecante ne pengimin e veprave penale ne shoqeri, bile ne disa raste ndikon ne nxitjen dhe shtytjen e individeve ne sjelle negative. Ku personat me arsimim kane aftesi qe me lehet edhe pa veshtersi te kryejne vepra penale te vjedhjes, ku arsimimi keta persona ju ndihmon qe ti shmangen e ndjekjes penale dhe gjykimit per veprimet dhe sjelljet e tyre.

Nje nga te verteta e pamohueshme eshte se te dhenat e ndryshme statistikave gjyqersore , te shum vendeve tregojne se pjesemarrja e personave te paarsimuar ose me shkallte te ulet te arsimit eshte me madhe ne kryrejen e sjelleve penale ne shume vende te botes. Siq kemi te bejme me kryerjen e veprimeve si veprat penale kunder pasurise, kunder ekonomis, etj..

Ne vendin tone numri me i madhe te veprave penale te vjedhjes kryejne personat me arsim me te ulet dhe analfabetik, por ne kohet e fundit dominojne edhe personat me arsim te larte te cilet i kryejne keto vepra penale.

### 1.1 Roli i mediave të shkruara dhe elektronike

Në drejtim të aktivizimit të opinionit për luftë kundër kriminalitetit rol të rëndësishëm luan edheinformimi i drejtë i qytetarëve në lidhje me sjelljet kriminale në një mjedis të caktuar.<sup>93</sup>

Arritja einformimit të qytetarëve në lidhje me këto bëhet në mënyra të ndryshme si mjetet informimit

publik ( radio, televizion, filmi, shtypi etj).

Roli i tyre është i madh pasi që ato paraqesin një roltë rëndësishëm edukativ. Me qëllim të nxitjes së efekteve pozitive të qytetarëve shtypi nukduhet të bjerë nën ndikimin e efekteve sensacionale por duhet të jep informata të sakta dhe objektive qoftë në lidhje me kriminalitetin si dukuri por edhe ne rastet e posaçme të aktivitetitkriminale<sup>94</sup>. Vetëm

---

<sup>93</sup>Vesel Latifi, " Politika Kriminale" , Prishtinë, 2003;

<sup>94</sup> Prof.Dr. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011.

me informime të sakta do të zgjohej interesimi pozitivë ndër qytetarët për angazhim në dhe rëndësinë e prevencionit shoqëror kundër kriminalitetit.

